

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6048
E shtunë, 27 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Vdesin edhe dy pacientë me Covid-19 në Kosovë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKË E RE", BEKIM BRESTOVCI

Do të jem urë lidhëse në mes të Kosovës dhe diasporës

Zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Bekim Brestovci, ka bërë me dije se do të jetë një urë lidhëse e Kosovës me diasporën. Ai ka thënë se me emërimin e tij në këtë pozitë qasja ndaj diasporës do të jetë më ndryshe pasi do të ndërmerret disa iniciativa që do të jenë në dobi të shtetit të Kosovës dhe diasporës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Brestovci ka theksuar se një nga iniciativat e tij është që të krijohet një shoqëri aksionare, e cila do ta bëjë grumbullimin e kapitalit nga diaspora dhe më pas iu qaset sektorëve në të cilët nevojitet të investohet si dhe një këshill për diasporën që do të kishte lidhje të drejtpërdrejtë me Kuvendin e Kosovës. Brestovci në këtë intervistë ka theksuar se është nevojshme për Kosovën që të ketë edhe atashe ekonomike



OPINION

PSE TANI? F. 7

Bedri ISLAMI



AKTUALE



KOMISIONI EVROPIAN MBËSHTET RIFILLIMIN E DIALOGUT KOSOVË - SERBI F. 2

VELIU: GJATË 2019-S KOSOVA KA ARRITUR PËRPARIM NË LUFTËN KUNDËR ABUZIMIT ME DROGA F. 6

BEKIM JASHARI VAZHDON VIZITAT TE FAMILJET E DËSHMORËVE F. 10

EKONOMI



ASK-ja TREGON SA KA TOKË BUJQËSORE NË KOSOVË DHE ME ÇKA MBILLET AJO F. 9

NËNTË PUNËTORË TË KEK-ut SHËROHEN NGA COVID-19 F. 9

SPORT

FAZLIU: KATËR PIKË NUK JANË SHUMË, DUHET TË VAZHDOJMË ME FITORE F. 18



PRESIDENTI HASHIM THAÇI TË DIELËN DO T'U DREJTOHET QYTETARËVE PAS AKTAKUZËS NGA ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

Thaçi: Askush nuk mund ta rishkruajë historinë e Kosovës

Presidenti Hashim Thaçi të premten është kthyer në Tiranë dhe nga atje ka paralajmëruar se këtë të diel nga zyra e vet në Prishtinë do t'u drejtohet qytetarëve me një fjalim pas dorëzimit të aktakuzës nga Zyra e Prokurorit të Specializuar për krime lufte. Ai ka thënë se askush nuk mund ta rishkruajë historinë e Kosovës.

Ndërkaq familja e presidentit Hashim Thaçi në një deklaratë për media ka bërë me dije se ditët e fundit ka pasur interesim të jashtëzakonshëm të të afërmeve të familjes, miqve dhe qytetarëve, për ta vizituar në shtëpinë e tyre në Burojë, por për shkak të pandemisë e ka të pamundur të presë qytetarë në shtëpi

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Bashkimi Evropian (BE) pret rifillim të shpejtë të dialogut Kosovë - Serbi

Komisioni Evropian mbështet rifillimin e dialogut Kosovë - Serbi

Presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, ka shprehur mbështetje për rifillimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas takimeve që ka pasur në dy ditët e fundit me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ajo ka thënë se vazhdimi i këtij procesi është thelbësor për përparimin e këtyre vendeve drejt BE-së



EPOKA ERE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, ka shprehur mbështetjen e saj për rifillimin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Gjatë takimi me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ajo ka thënë se vazhdimi i këtij procesi është thelbësor për përparimin e këtyre vendeve drejt BE-së.

Zyrtarja e lartë e BE-së në takimin që ka pasur me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti, të enjten dhe me presidentin serb, Aleksander Vuçiq, të premten, ua ka premtuar atyre mbështetjen në reformat ekonomike. Ajo ka thënë se BE-ja do ta mbështesë Kosovën në reformat e nevojshme në rrugën e saj drejt BE-së si dhe në rimëkëmbjen pas pandemisë së koronavirusit. "Jam mirënjohëse që ai [Hoti] e

zgjodhi Brukselin për udhëtimin e tij të parë jashtë vendit", ka shkruar von der Leyen përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", pas takimit që ka zhvilluar me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti, të enjten në Bruksel.

Sipas shërbimit për shtyp të KE-së, Ursula von der Leyen edhe me presidentin serb është pajtuar për rëndësinë e përparimit të Serbisë në reformat e nevojshme për anëtarësimin në BE, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit.

Është thënë se presidentja e KE-së e ka inkurajuar udhëheqjen serbe që, pas zgjedhjeve parlamentare në Serbi, të zhvillojë një dialog të mirëfilltë me të gjitha forcat politike, me qëllim të inicimit të reformave të cilat kërkojnë një konsensus të gjerë.

Pas takimit me zyrtaret e lartë të BE-së, edhe Vuçiqi ka

paralajmëruar vazhdimin e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës. "Para kësaj ne jemi në pritje të një samiti, në të cilin do të marrin pjesë përfaqësues të vendeve më të mëdha evropiane, i cili do të ketë të bëjë me vazhdimin e dialogut, por edhe përshpejtimin e mëtutjeshëm të rrugës së Serbisë në BE", ka thënë Vuçiqi. Në këtë takim ka qenë i pranishëm edhe përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun midis Prishtinës dhe Beogradit, Mirosllav Lajçak.

Gjatë vizitës në Bruksel,

kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, është takuar me presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel, i cili ka thënë se është e nevojshme të vazhdohet dialogu mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve. Procesi i dialogut Kosovë - Serbi është ndërprerë në fund të vitit 2018 për shkak të një takse që u ka vënë Qeveria e atëhershme e Kosovës prodhimeve të importuara nga Serbia. Pas largimit të taksës dhe reciprocitetit ndaj Serbisë, tani pritet të rifillojë dialogu në mes

të Kosovës dhe Serbisë. Takimi i parë për fillimin e këtij dialogu ishte planifikuar të mbahej më 27 qershor në Uashington, mirëpo ky takim është anuluar pasi Gjykata Speciale ka ngritur aktakuzë për krime lufte ndaj presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Pas kësaj aktakuze, kryeministri Hoti ka anuluar pjesëmarrjen në këtë takim. Ndërsa i dërguari i posaçëm i ShBA-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka bërë me dije se së shpejti do ta ricaktojë datën për takimin e Uashingtonit.

Bregu: Është në dorën e rajonit ta ruajë angazhimin për bashkëpunim rajonal



PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Janë mbajtur dy takimet në kuadër të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore (SEECP): takimi i ministrave të jashtëm të SEECP dhe takimi Vjetor i RCC që u organizuan në kuadër të kryesimit së SEECP-së nga Kosova.

Sekretarja e përgjithshme e RCC-së, Majlinda Bregu, ka shprehur mirënjohje të sinqertë për kolegët nga Prishtina për të gjitha përpjekjet e investuara në këtë vit të kryesimit të SEECP-së dhe ka përgëzuar Ankaranë për kryesimin e ardhshëm të SEECP-së. "Bashkëpunimi rajonal ka uljet dhe ngritjet e tij, por kohë si këto kërkojnë thellimin e rritjes ekonomike

dhe zhvillimit të Ballkanit Perëndimor. Është arritur shumë, por mbetet edhe më shumë për të bërë. Rishpreh angazhimin se në RCC jemi të vendosur për të arritur rezultate, por bashkëpunimi rajonal nuk është një proces teknik, suksesi i të cilit varet vetëm nga takimet dhe strategjitë në letër. Është një proces politik, që ndikohet nga situatat politike dhe sfidat që janë të shumëfishta. Nuk mund të kemi sukses nëse nuk do të jemi të gjithë të angazhuar në mënyrë proaktive për t'i ndaluar kërcënimet ndaj stabilitetit dhe progresit rajonal", ka thënë Bregu.

Ajo ka theksuar se problemet

rajonale kërkojnë zgjidhje rajonale. "Që integrimi ekonomik rajonal të ketë sukses dhe ta lidhë plotësisht rajonin me tregun e përbashkët të BE-së, ne kemi nevojë për qartësi dhe gatishmëri politike të të gjithë aktorëve dhe partnerëve për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse bashkëpunimi në Ballkanin Perëndimor. Është në dorën e vet rajonit që ta ruajë përkushtimin për bashkëpunim si mjet i cili në mënyrë të pandryshueshme mund të sjellë përparim të prekshtëm dhe të mos zhgënjë mbështetjen e madhe të qytetarëve për bashkëpunimin rajonal dhe anëtarësimin në BE", ka thënë Bregu.

Presidenti Hashim Thaçi të dielën do t'u drejtohet qytetarëve pas aktakuzës nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Thaçi: Askush nuk mund ta rishkruajë historinë e Kosovës

Presidenti Hashim Thaçi të premten është kthyer në Tiranë dhe nga atje ka paralajmëruar se këtë të diel nga zyra e vet në Prishtinë do t'u drejtohet qytetarëve me një fjalim pas dorëzimit të aktakuzës nga Zyra e Prokurorit të Specializuar për krime lufte. Ai ka thënë se askush nuk mund ta rishkruajë historinë e Kosovës. Ndërkaq familja e presidentit Hashim Thaçi në një deklaratë për media ka bërë me dije se ditët e fundit ka pasur interesim të jashtëzakonshëm të të afërmeve të familjes, miqve dhe qytetarëve, për t'i vizituar në shtëpinë e tyre në Burojë, por për shkak të pandemisë e kanë të pamundur të presin qytetarë në shtëpinë e tyre



të dyshuar të tjerë janë penalisht përgjegjës për afërsisht 100 vrasje të paligjshme", është thënë në njoftimin e ZPS-së. Në njoftim theksohet se një gjykatës i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës është duke e shqyrtuar aktakuzën për të vendosur nëse do t'i konfirmojë akuzat. Lajmi për ngritje të aktakuzës e ka gjetur Thaçin në rrugë drejt Shteteve të Bashkuara, ku ishte planifikuar të mbahej një takim me zyrtarët serbë, me ndërmjetësim të të dërguarit të Shtëpisë së Bardhë për dialogun mes këtyre dy shteteve, Richard Grenell. Takimi në Shtëpinë e Bardhë është parë si rinisje e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, i cili është ndërprerë qysh në fund të vitit 2018, pasi Kosova u ka vënë taksë 100 për qind mallrave të importuara nga Serbia për shkak të fushatës së saj kundër pavarësisë së Kosovës.

Familja e presidentit Thaçi në Burojë shpreh falënderim për qytetarët që po solidarizohen me të

Familja e presidentit Hashim Thaçi përmes një deklaratë për media ka bërë me dije se ditët e fundit ka pasur interesim të jashtëzakonshëm të të afërmeve të familjes, miqve dhe qytetarëve për t'i vizituar në shtëpinë e tyre në Burojë në shenjë solidarizimi për momentet sfiduese nëpër të cilat po kalon kjo familje, pasi Prokuroria Speciale e Hagës ka njoftuar për aktakuzën kundër Hashim Thaçit.

Familja Thaçi në Burojë ka theksuar se për shkak të pandemisë e ka të pamundur që

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Presidenti Hashim Thaçi ka bërë me dije se këtë të diel nga zyra e tij do t'u drejtohet qytetarëve me një fjalim, pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dërguar në Dhomat e Specializuara të Kosovës aktakuzë kundër tij për krime lufte. Thaçi në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" u ka uruar qytetarëve një fundjavë të qetë. "Mbetem me shpresë të plotë se ditët më të mira për Kosovën dhe kombin shqiptar i kemi përpara", ka shkruar presidenti.

Presidenti përmes një postimi tjetër në rrjetet sociale ka thënë se askush nuk mund ta rishkruajë historinë e Kosovës.

Zyra e Prokurorit të Specializuar të mërkurën ka dërguar në Dhomat e Specializuara të Kosovës, me seli në Hagë, një aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim, në të cilën presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, akuzohen për krime lufte.

Në një komunikatë për media, Zyra e Prokurorit ka bërë me dije se Thaçi, Veseli dhe të dyshuarit e tjerë janë penalisht përgjegjës për afërsisht 100 vrasje të paligjshme. "Më 24 prill 2020 Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ua paraqiti Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) një aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim prej Gjykatës, ku Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe të tjerë akuzohen për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krime lufte, ndër të cilat, për vrasje të paligjshme, për zhdukje të detyruar të personave, për përndjekje dhe tortura. Në aktakuzë pretendohet se Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe

t'i presë qytetarët në shtëpi. "Të nderuar familjarë, miq dhe bashkëkombës. Ditët e fundit ka pasur interesim të jashtëzakonshëm të të afërmeve të familjes, miqve dhe qytetarëve për të na vizituar në shtëpinë tonë në Burojë, në shenjë solidarizimi për momentet sfiduese nëpër të cilat po kalojmë. Jemi thellësisht mirënjohës për interesimin tuaj dhe për solidarizimin me ne si

familje, mirëpo për shkak të pandemisë e kemi të pamundur që t'ju presim në shtëpinë tonë sipas nderit, traditës së familjes dhe të popullit tonë. Shëndeti juaj është shumë më i rëndësishëm se gjithçka tjetër! Jemi falënderues përjetësisht për mbështetjen që keni treguar për më tepër se dy dekada për birin, babanë dhe vëllanë tonë, presidentin Hashim Thaçi, i cili me gjithë qenien e tij ka punuar për lirinë, pavarësinë dhe shtetndërtimin e Kosovës. Askush nuk mund ta rishkruajë historinë e Kosovës, e as ta zhbëjë sakrificën e shqiptarëve për liri, pavarësi dhe shtetndërtim. Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit! Lavdi luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Ju faleminderit nga zemra për mbështetjen e vazhdueshme", thuhet në deklaratën e familjes Thaçi në Burojë.

Meta për Thaçin dhe Veselin: Do ta përballojnë me dinjitet këtë sfidë

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka komentuar aktakuzën ndaj presidentit Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit të cilët akuzohen për krime lufte nga Specialja. Ai ka thënë se ka komunikuar me Thaçin dhe Veselin dhe u shpreh se ata kanë të gjithë qetësinë për ta përballuar me dinjitet këtë sfidë. "Nuk është momenti të merremi me

drejtësinë ndërkombëtare. Miratimi i kësaj gjykate ka qenë një akt i sforcuar dhe e dimë këtë nga të gjithë faktorët që ai është shtyrë, ku në radhë të parë është vetë pala që shkaktoi gjenocidin dhe s'pranon realitetin e ri, si shteti i ri i Kosovës. Drejtuesit e UÇK-së i kanë fituar betejat me drejtësinë ndërkombëtare dhe e dimë shumë mirë kush

është pala që është dënuar më shumë dhe kush nuk është dënuar. Është momenti për unitet dhe urtësi në Shqipëri dhe në Kosovë. Mos të ushqejmë mosbesim ndaj aleatëve tanë. Kam pasur komunikim edhe me Thaçin dhe Veselin. Jam i bindur që kanë të gjithë qetësinë për ta përballuar me dinjitet këtë sfidë", ka thënë Meta.

FLET PËR “EPOKË E RE”, BEKIM BRESTOVCI

DO TË JEM URË LIDHËSE NË MES



Zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Bekim Brestovci, ka bërë me dije se do të jetë një urë lidhëse e Kosovës me diasporën. Ai ka thënë se me emërimin e tij në këtë pozitë qasja ndaj diasporës do të jetë më ndryshe pasi do të ndër marrë disa iniciativa që do të jenë në dobi të shtetit të Kosovës dhe diasporës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Brestovci ka theksuar se një nga iniciativat e tij është që krijohet një shoqëri aksionare, e cila do ta bëjë grumbullimin e kapitalit nga diaspora dhe më pas iu qaset sektorëve ku nevojitet të investohet si dhe një këshill për diasporën që do të kishte lidhje të drejtpërdrejtë me Kuvendin e Kosovës. Brestovci në këtë intervistë ka theksuar se është nevojshme për Kosovën që të ketë edhe atashe ekonomikë

mësimi i gjuhës shqipe dhe aktivitetet kulturore e sportive. Unë e konsideroj veten përfaqësues të diasporës në Kosovë. Diaspora për aktivitetin tim di që nga vitet e '90 sepse kam qenë protagonist i shumë çështjeve që kishin të bënin drejtpërsëdrejti me Kosovën, duke filluar nga fondi 3 për qind, fondi Vendlindja Thërret për ta ndihmuar luftën, pastaj edhe aktivitetet e tjera në Unionin e Bizneseve, si ndarja e 5 000 bursave vjetore për studentë nga Kosova. Po ashtu, kemi marrë 35 të rinj në Gjermani për shkollim profesional. Gjithashtu, kemi iniciuar edhe lejet e punës për vendet e treta. Krejt këto iniciativa të Unionit të Bizneseve. Diaspora e ka të qartë se jam këtu për ta ndihmuar atë dhe të jem urë lidhëse në aspektin ekonomik, me fokus të veçantë në shkollimet profesionale.

“Epoka e re”: Pse e zgjodhët pikërisht një parti socialdemokrate në aspektin ideologjik?

Brestovci: Arsyeja e inkuadrimit tim në politikë ka të bëjë me diasporën. Para zgjedhjeve të 6 tetorit kam bërë një koncept i cili kishte të bënte me përfshirjen e diasporës në jetën politike. Këtë koncept ua kam prezantuar disa partive politike: PDK-së, Vetëvendosjes dhe Nismës. Bindja ime ka qenë se Nisma Socialdemokrate do të na krijojë më shumë hapësirë për diasporën dhe kjo u vërtetua. Tani në Nismën Socialdemokrate mbaj edhe postin e sektorit organizativ. Nisma Socialdemokrate ka elemente të socialdemokracisë dhe kjo është arsyeja që jam pjesë e saj. Unë jam fëmija i dy prindërve që në gjysmën e jetës së tyre kanë punuar në Qendrën për Punë Sociale dhe janë marrë me polet sociale të

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 QERSHOR -

“Epoka e re”: Z. Brestovci, pas emërimit tuaj në pozitën e zëvendësministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, cili do të jetë roli juaj karshi diasporës?

Brestovci: Natyrisht përcaktimi im për të qenë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është fakti se kësaj ministrie i është shtuar edhe

dikasteri i diasporës, që ka qenë pikënisja ime kryesore për vendimmarrje. Jam kthyer para dy vjetësh në Kosovë. Para se të vija në Kosovë kam qenë drejtor ekzekutiv i Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, njëri nga organizatat më të fuqishme ekonomike shqiptare në të gjithë globin. Pas ardhjes sime në Kosovë vendosa ta ndryshoj formatin dhe të kem aktivitet politik, me arsyen që aktiviteti im të lidhet me diasporën. Një

ndër iniciativat e mia do të jetë edhe krijimi i një Këshilli të Diasporës sepse, bazuar në Kushtetutën që është në fuqi, s'ka mundësi që diaspora të ketë vende të rezervuara. Andaj është e nevojshme që të kemi një këshill të diasporës i cili do të ishte një lidhje e drejtpërdrejtë me Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu, do të jem dhe iniciues i mbështetjes së shumë aktiviteteve që kanë të bëjnë me diasporën, të cilat realizohen në diasporë, si

TË KOSOVËS DHE DIASPORËS

suksesshëm, mund të shihni një djathist, por jam i edukuar në aspektin e socialdemokracisë.

“Epoka e re”: Ndonëse kemi numër të madh biznesesh nga diaspora, nuk është parë ndonjë iniciativë e madhe për të investuar në Kosovë. Çfarë sfida adresojnë këto biznese?

Brestovci: Është fakt që shqiptarët në Gjermani kanë avancuar shumë, po ashtu edhe në shtetet e tjera të botës. E përmenda më herët se unë i përkas Unionit të Bizneseve Shqiptare dhe se unione të tilla janë të sistemuara në 24 shtete të botës. Do të thotë, është një akumulim i madh i biznesmenëve në unione. S’mund të konstatojmë se investimet e diasporës kanë qenë të mangëta. Besoj se 50 për qind e bizneseve aktuale në Kosovë kanë ardhur nga diaspora, por që nuk janë të listuar si biznese të diasporës. Mirëpo, kemi konstatuar se bizneset individuale nuk janë të përmasave të mëdha që lënë gjurmë në zhvillimin ekonomik të vendit. Prandaj, iniciativa ime është që të kalojmë në një format më ndryshe. Bizneset shqiptare të diasporës të krijojnë shoqëri aksionare. Do të thotë, ta bëjnë grumbullimin e kapitalit nga diaspora dhe më pas t’u qasemi sektorëve ku nevojitet të investohet. Unë kam listuar industrinë ushqimore, turizmin malor, si dhe fushën e blegtorisë, pa i anashkaluar sektorët tjerë që mendojmë t’i

zhvillojë përmes funksionalizmit apo krijimit të zonave ekonomike për diasporën. Bizneset shqiptaro-gjermane kanë prezantuar një iniciativë për krijimin e një parku industrial për bizneset e diasporës në Malishevë, iniciativë kjo që është filluar në qeverinë Haradinaj e që, fatkeqësisht, në qeverinë Kurti ka pasur ngecje. Këto iniciativa duhet të jetësohen.

“Epoka e re”: Z. Brestovci, e përmendet krijimin e një këshilli të diasporës. Çfarë përbërje do të ketë ky këshill?

Brestovci: Akoma nuk e kemi finalizuar si format. Për momentin është një ide e imja personale e cila duhet ta ketë vulën institucionale. Mendohet që në këtë këshill të ketë anëtarë nga e gjithë diaspora shqiptare. Format i Këshillit të Diasporës do të dërgohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

“Epoka e re”: Sa anëtarë janë në Unionin e Bizneseve Gjermano-Shqiptare?

Brestovci: Unioni i Bizneseve Gjermano-Shqiptare ka 500 firma aktive. Një pjesë e madhe e tyre janë firma të ndërtimit, kurse një pjesë tjetër janë kompani në fushën e gastronomisë. Pra, kemi numër të madh të firmave shërbyese, por fokusi më i madh është te gastronomia dhe ndërtimtaria.

“Epoka e re”: Përmendët dhe krijimin e një zone ekonomike

për diasporën. Nuk mjaftojnë zonat ekonomike të cilat i kemi?

Brestovci: Ne duhet të kemi partneritet në mes të shtetit të Kosovës dhe afaristëve shqiptarë, prandaj do të jemi dorë e zgjatur për të krijuar lehtësira për investitorët nga diaspora. Në këtë mënyrë është menduar një format i tillë, ku qeveria afron prona në dispozicion për ata që dëshirojnë të investojnë në prodhimtari. Diaspora ka kapacitete për të investuar, por nevojitet dora e shtetit për të krijuar lehtësira.

“Epoka e re”: Si e keni parë idenë e Grenellit për të krijuar një Zonë Minishenzen?

Brestovci: Çdo ide që vjen nga Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja duhet të merret seriozisht dhe duhet bërë studim për t’i parë favorët dhe disfavorët potenciale. Jo çdo mekanizëm mund të sjellë përfitime. E kemi rastin e CEFTA-s që nuk ka sjellë edhe shumë favore për Kosovën. Duhet të bëhet një analizë e thuktë dhe të dilet me një qëndrim të përbashkët.

“Epoka e re”: Kosova ka mungesë të atashëve ekonomikë. Sa e pengon vendin kjo në aspektin e tërheqjes së investitorëve të huaj?

Brestovci: Atashetë janë domosdoshmëri ekonomike për vendin tonë dhe për diplomacinë ekonomike. Ne duhet që në ato shtete ku shohim potencial për tërheqjen e investitorëve të kemi atashë ekonomikë, në mënyrë që të jemi urë lidhëse dhe t’u

krijojmë mundësi atyre që të investojnë në kohë sa më të shkurtër.

“Epoka e re”: A do të merreni ju me këtë iniciativë?

Brestovci: Unë edhe pa qenë zëvendësministër dhe pjesë e politikës, qeverisë Haradinaj i kam drejtuar një kërkesë për emërimin e atashëve ekonomikë, pasi e kemi parë të domosdoshme që të ketë atashë, sidomos në shtetin e Gjermanisë.

“Epoka e re”: A duhet të kanalizohen në më shumë lëmë investimet nga diaspora, meqë shumica prej tyre shkojnë në fushën e patundshmërisë?

Brestovci: Remitancat dhe investimet në patundshmëri kanë qenë domosdoshmëri, pasi secili mërgimtar dëshiron ta ketë një vendqëndrim. Ne duhet të kalojmë në formate të tjera që të krijojmë hapësirë dhe lehtësira për kanalizim të investimeve, duke dhënë ide për projekte të ndryshme. Pra, duke filluar nga krijimi i fondeve të përbashkëta investive përmes Shoqërive Akisionare, që është e domosdoshme për të pasur një qasje më aktive që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik.

“Epoka e re”: Sipas jush, sa do të ndikojë pandemia në rënien e remitancave?

Brestovci: Nëse e analizojmë me rënien që ishte në krizën e vitit 2014, pritet një rënie deri në 10 për qind. Nuk besoj se do të jetë më e madhe.

shoqërisë, që kanë lënë gjurmë në edukimin tim. Në shpirt jam socialdemokrat. Nëse shihet biografia ime prej një afaristi të

Vdesin edhe dy pacientë me Covid-19 në Kosovë

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Dy pacientë të prekur me Covid-19 në Kosovë kanë vdekur të premtën. Në njoftimin e Klinikës Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, viktimat identifiko-hen si A. M., i lindur më 1964, nga Komuna e Rahovecit, dhe H. K., i lindur më 1959, nga Prizreni. Me këta dy të vdekur, numri i viktimave nga Covid-19 në Kosovë shkon në 44. Klinika Infektive, po ashtu, ka njoftuar se të shtrirë në këtë klinikë janë 101 pacientë. “Dyzet e katër raste janë duke u trajtuar në reparte me oksigjenoterapi dhe përkujdesje

intensive. Në repartin e Mjekimit Intensiv janë duke u trajtuar 5 raste, 2 raste janë në gjendje të rëndë duke u trajtuar me oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive, si dhe 3 raste janë në gjendje kritike, me frymëmarrje të asistuar me respiratorë”, thuhet në njoftimin e Klinikës Infektive. Bëhet me dije se gjatë ditës do të lirohen 16 pacientë nga spitali, 13 prej tyre pozitivë me Covid-19 dhe në gjendje stabile, si dhe tre të shëruar nga Covid 19. Kosova deri më tash ka konfirmuar 2 432 raste me koronavirus. Prej tyre, mbi 1 140 mbeten aktive.



Ministri Zemaj viziton Istogun, interesohet për menaxhimin e situatës me Covid-19

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

ISTOG, 26 QERSHOR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vizituar të premten Komunën e Istogut, ku është pritur nga kryetari i kësaj komune, Haki Rugova. Gjatë kësaj vizite ministri Zemaj me kryetarin Rugova kanë biseduar për menaxhimin e pandemisë Covid-19 në këtë komunë, me ç'rast Zemaj i ka falënderuar autoritetet lokale dhe profesionistët

shëndetësorë të kësaj komune për përkushtimin e treguar gjatë kësaj kohe. Ai ka thënë se MSh-ja është duke fuqizuar aktivitetet e saj si në aspektin e shtimit të kuadrit mjekësor, po ashtu edhe të masave mbikëqyrëse për zbatimin e manualit për mbrojtje nga përhapja e Covid-19, të miratuar nga MSh-ja. Ministri Zemaj ka thënë se MSh-ja do të jetë afër komunave duke siguruar mbështetje për kujdesin parësor shëndetësor, duke e

ditur rëndësinë e këtij niveli që është porta e parë e luftimit të sëmundjeve. Ai ka kërkuar që institucionet dhe qytetarët e Komunës së Istogut ta zbatojnë manualin dhe masat në fuqi në funksion të ruajtjes së shëndetit publik. Kryetari i Istogut, Haki Rugova, e ka falënderuar ministrin për vizitën dhe bashkëpunim dhe e ka njoftuar atë me nevojat e kujdesit parësor shëndetësor në këtë komunë. Ai ka thënë se qendra operative e

emergjencës në këtë komunë ka menaxhuar në bashkëpunim me institucionet qendrore situatën rreth Covid-19 në këtë komunë. Gjatë vizitës në Istog, ministri Zemaj ka marrë pjesë edhe në përrurimin e shërbimit të maternitetit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjar, financiar nga fondet e Qeverisë së Republikës së Turqisë, ku ka theksuar bashkëpunimin e mirë me partnerët në funksion të furnizimit të shërbimeve shëndetësore për nënat dhe

fëmijët në Kosovë. Ai e ka falënderuar Turqinë për mbështetjen e dhënë sistemit shëndetësor të Kosovës dhe asistencën konkrete gjatë pandemisë. Ambasadori i Republikës së Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar, ka thënë se ky donacion nga populli i Turqisë për qytetarët e Komunës së Istogut shërben për ta rritur kujdesin shëndetësor, sidomos për nënat dhe fëmijët dhe se ky shtet do të mbetet i angazhuar që ta ndihmojë popullin mik të Kosovës.



Veliu: Gjatë 2019-s Kosova ka shënuar përparim në luftën kundër abuzimit me droga

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Me rastin e 26 qershorit, Ditës Ndërkombëtare Kundër Abuzimit me Droga dhe Trafikimit të Paligjshëm, ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka thënë gjatë vitit 2019 Kosova ka arritur një përparim të theksuar në luftën kundër abuzimit dhe trafikimit të paligjshëm të drogës. "Ministria e Punëve të Brendshme mbetet edhe më tutje e përkushtuar për ta

vazhduar luftën e pakompromis kundër kësaj dukurie negative dhe për përkrahjen e të gjitha institucioneve relevante të zbatimit të ligjit në këtë drejtim", ka thënë Veliu. Ai ka theksuar se tema e Ditës Ndërkombëtare 2020 Kundër Abuzimit me Drogën dhe Trafikimit të Paligjshëm, "Njohuri më të mira për kujdes më të mirë", përqendrohet në nevojën për të përmirësuar të kuptuarit e problemit botëror të drogës, por edhe të nxjerrjes së njohurive më të mira për nxitjen e bashkëpunimit më të



madh ndërkombëtar për ta kundërshtuar ndikimin e tij në shëndet, qeverisje dhe në siguri. "Ditët ndërkombëtare

janë raste për ta edukuar publikun e gjerë për çështje shqetësuese, për ta mobilizuar vullnetin politik dhe burimet

në adresimin e problemeve globale, si dhe për t'i festuar dhe përforcuar arritjet e njerëzimit kundër këtij fenomeni të dëmshëm shoqëror", ka thënë Veliu. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e vitit 1987 kishte përcaktuar 26 qershorin Ditë Ndërkombëtare Kundër Abuzimit me Drogë dhe Trafikimit të Paligjshëm si një shprehje e vendosmërisë për ta përforcuar veprimin e gjithëmbarshtëm dhe bashkëpunimin në ndërtimin e një shoqërie ndërkombëtare pa abuzim me drogë.

Legjitimiteti i 'kontestuar' i qeverisë

Prishtinë, 26 qershor - Qeveria e Kosovës ka mandatin ligjor dhe kushtetues për përfaqësimin e vendit në dialogun me Serbinë, por ajo do të ketë legjitimitet të cunguar për të arritur marrëveshje eventuale dhe për ta ratifikuar më pas atë në Kuvendin e Kosovës për shkak se i mungon mbështetja e shumicës së deputetëve të partive shqiptare, të cilët janë në opozitë, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në Prishtinë.

Zyrtarët e Bashkimit Evropian kanë deklaruar që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është paraparë të rinisë në korrik të këtij viti dhe këtë ia kanë bërë të ditur edhe kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, gjatë qëndrimit të tij në Bruksel, ditën e enjte.

Arbëresha Loxha, drejtoreshë e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se pas zhvillimeve të fundit është përgjegjësi kushtetuese e qeverisë së vendit dhe e kryeministrit Hoti që të sigurojnë pajtim të gjerë politik ndërmjet të gjitha grupeve parlamentare në mënyrë që të unifikohet pozicioni negociues i Kosovës në raport me Serbinë. Sipas saj, pa unitet të spektrit politik brenda Kuvendit të Kosovës do të jetë i vështirë ose i pamundur ratifikimi i çfarëdo marrëveshjeje që mund të arrihet në dialog. "Për më tepër,

proceset e tilla, si dialogu me Serbinë, të cilat kanë peshë të madhe politike dhe historike, nuk duhet asnjëherë të trajtohen si nisma vetjake. Përkundrazi, duhet të nxisin bashkëpunim dhe pajtim të gjerë politik. Prandaj, gjithçka rreth dialogut, qoftë procesi juridik, qoftë mbështetja politike e marrëveshjes, duhet të burojë, të konceptohet dhe të përfundojë në Kuvend. Pra, përveç rolit dhe përgjegjësisë që qeveria e ka që të shkojë dhe të na përfaqësojë në dialog, e ka edhe një përgjegjësi shumë të madhe, që ta krijojë shumicën e gjerë parlamentare, në mënyrë që, në rast se arrihet çfarëdo marrëveshje eventuale në të ardhmen, t'i ketë votat për ta ratifikuar", ka thënë Loxha.

Por, situata është komplikuar edhe më shumë pas paraqitjes së aktakuzës për shqyrtim nga Zyra e Prokurorit të Specializuar me seli në Hagë, në Dhomat e Specializuara, e cila i ngarkon presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veselin dhe të tjerë, në akuzën për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krimesh lufte



ndër të cilat, vrasje e paligjshme, zhdukje e detyruar e personave, përndjekje dhe tortura.

Ende nuk është e qartë se kush bën pjesë në grupin e "të tjerëve", siç i ka cilësuar Zyra e Prokurorit.

Menjëherë pas paraqitjes së kësaj aktakuze, presidenti Thaçi, por edhe kryeministri Hoti, kanë anuluar pjesëmarrjen në takimin e 27 qershorit në Uashington, që do të organizohej në Shtëpinë e Bardhë mes zyrtarëve të Kosovës dhe atyre të Serbisë.

Njohësja e zhvillimeve politike, Donika Emini, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ka theksuar që anulimi i këtij takimi nga kryeministri Hoti nuk është dashur të ndodhë për shkak se qeveria e ka ligjshmërinë që ta udhëheqë dialogun. Por, sipas saj, kjo situatë ka shpërfaqur pikëpyetjen për legjitimitetin e qeverisë aktuale.

"Tash, për momentin, nuk besoj që kjo qeveri ka legjitimitet dhe është edhe më tej më e dobët. Ne kemi menduar që, së paku, nëse një marrëveshje negociohet dhe nënshkruhet

prej Thaçit, do të mbështetej në Kuvend edhe nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Nëse kjo nuk ndodhë, atëherë nuk besoj që PDK-ja do të mbështesë këtë marrëveshje. Edhe këto ditë e pamë në Kuvend që PDK-ja ishte një opozitë po aq sa Lëvizja Vetëvendosje. Nuk besoj që kjo qeveri ka fuqi politike për ta udhëhequr dialogun, e hiç më pak për të ratifikuar një marrëveshje në Kuvend", ka theksuar Emini.

Për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, nevojiten të paktën 81 vota të 120 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ndërkohë që qeveria e kryeministrit Hoti është formuar me 61 vota, në kuadër të së cilave janë edhe ato të Listës Serbe, si partnere e koalicionit qeverisës.

Partitë opozitare, Lëvizja Vetëvendosje ka 31 deputetë, ndërkaq, Partia Demokratike e Kosovës ka 24 deputetë. Ditë më parë, Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të ratifikojë një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare financiare pasi partitë opozitare nuk pranuan t'i votojnë ato.

Njohëset e zhvillimeve politike

vlerësojnë që Kosovës i nevojitet një qeveri me më shumë legjitimitet përfaqësues, në mënyrë që t'i qaset dialogut.

Arbëresha Loxha i sheh zgjedhjet e parakohshme parlamentare si dalje nga kjo situatë. "Mendoj që ideale do të ishte që të shkohej në zgjedhje, sepse e dimë që kjo qeveri ka një shumicë shumë të brishtë. Kjo u vërtetua me rastin e miratimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në Kuvend, por edhe pasigurive nëse do të mund të votohet rishikimi i buxhetit për vitin 2020. Për një çështje të tillë, siç është dialogu, kërkohet një legjitimitet shumë më i madh dhe jo 61 vota të brishta dhe të cilat janë me pikëpyetje, sepse jo domosdo mund t'i ketë kjo qeveri, marrë parasysh edhe faktin që pjesë e kësaj qeverie është edhe Lista Serbe. Kjo e fundit, jo domosdo mund të pajtohet dhe mund të dëshirojë të votojë një marrëveshje eventuale me Serbinë", u shpreh Loxha.

Megjithatë, analistja Emini vlerëson që, paraprakisht, kryeministri Hoti, duhet të zhvillojë takime të brendshme me elitën politike në vend,

Akademienë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe shoqërinë civile, ashtu siç e parasheh në platformën e tij, për të siguruar një unitet të brendshëm. Në rast se, sipas saj, zgjedhjet do të jenë të pashmangshme, atëherë ato të paktën do t'ia humbin Kosovës një vit kohë. "Absolutisht, nëse nuk ka konsensus të brendshëm politik, nëse nuk ka dialog të brendshëm politik dhe pajtim në raport me dialogun me Serbinë në kuadër të BE-së, atëherë nuk ia vlen që të nënshkruhet marrëveshja. Nuk ia vlen të kthehem në dialog pa pasur zgjedhje dhe pa i rikonfirmuar pozicionet politike, sidomos të atyre që do ta udhëheqin vendin në dialog", vlerësoi Emini.

Njohëset e zhvillimeve politike vlerësuan që në rast se presidenti Thaçi eventualisht ofron dorëheqje, atëherë Kuvendi i Kosovës duhet ta zgjedhë presidentin e ri. Por, në rast se partitë politike parlamentare nuk do të arrijnë ta zgjedhin presidentin as pas votimit për herë të tretë atëherë, sipas tyre, vendi me siguri që do të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Nëntë punëtorë të KEK-ut shërohen nga Covid-19

Prishtinë, 26 qershor (ER) - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka bërë me dije se janë shëruar nëntë punëtorë që kanë dalë pozitivë me Covid-19 në fillim të këtij muaji. Në anën tjetër, katër punëtorët që kanë dalë pozitivë në javën e fundit janë në gjendje të mirë shëndetësore.

KEK-u bën me dije se nga fillimi i këtij muaji e deri me sot kanë qenë gjithsej 13 raste që kanë rezultuar pozitiv me Covid-19. "Në vetizolim kanë qenë njëqind e katër (104) punëtorë, gjashtëdhjetë e katër (64) prej tyre e kanë përfunduar vetë

izolim prej 14 ditësh dhe janë ftuar ta rifillojnë punën pasi që nuk kanë simptoma të infektimit me virus. Në këtë drejtim, KEK-u vazhdon të jetë në kontakt të vazhdueshëm me katër kolegët tanë që janë ende aktivë me këtë virus duke përcjell gjendjen e tyre shëndetësore, edhe pse deri më tani gjendja e tyre është stabile. Për më tepër, KEK-u, në bashkëpunim të ngushtë me IKShPK-në, po vazhdon t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19", është



thënë në njoftimin për media. Në këtë njoftim theksohet se në vazhden e masave mbrojtëse

dhe në respektim të rekomandimeve nga IKShPK-ja, Komiteti i Sigurisë dhe KE-së,

pas analizimit të situatës, ka vendosur ta rikthejë orarin e punës në 12 orë, hap ky që ka shmangur në masë lëvizjen e punëtorëve të cilët udhëtojnë nga të gjitha trevat e Kosovës. "Menaxhmenti i KEK-ut bënë apel edhe një herë të të gjithë punëtorët që të jenë vigilentë kudo që ndodhen për respektimin e rekomandimeve të IKShKP-së, duke mbajtur distancën sociale dhe përdorur pajisjet e nevojshme mbrojtëse, veprime këto të domosdoshme për ta parandaluar përhapjen e pandemisë", thuhet në njoftimin e KEK-ut.

Ministri Kuçi bisedoi me drejtorin e ri të Bankës Botërore, Massimiliano Paolucci

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Blerim Kuçi, ka zhvilluar një takim virtual me drejtorin e ri të Bankës Botërore për Kosovë, Massimiliano Paolucci. Takimi ishte me karakter njohës nga të dyja palët, ku është diskutuar për gjendjen ekonomike në Kosovë, e krijuar si pasojë e

pandemisë Covid-19. Ministri Kuçi, pasi ka falënderuar Paoluccin për mbështetjen që Banka Botërore ia ka dhënë Kosovës, po ashtu e ka njoftuar për nëntë masat që ka paraparë Qeveria e Kosovës të ndërmarrë për rimëkëmbjen ekonomike në vend. Paolucci i ka premtuar

ministrit Kuçi mbështetjen e Bankës Botërore për Kosovën edhe në të ardhmen, në veçanti pas situatës së vështirë ekonomike të krijuar në Kosovë si pasojë e pandemisë. Massimiliano Paolucci e merr detyrën e drejtorit të Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut më 1 korrik 2020.



Mbahet punëtorja për planifikimin e financimit të shërbimeve sociale në nivel lokal

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ), në mbështetje të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ka organizuar punëtorinë virtuale me temë "Planifikimi i financimit të shërbimeve sociale në nivel lokal". Pjesëmarrës në këtë sesion trajnues ishin përfaqësues të Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS) në nivel lokal.

Qëllimi i takimit ishte planifikimi i financimit të shërbimeve sociale në nivel lokal dhe financimi përmes komisionit të granteve. U pasqyrua propozimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për Komisionin e Granteve për financim të shërbimeve sociale; Planifikimi i buxhetit për vitin 2021 nga komunat, si dhe ndikimi shtesë si pasojë e pandemisë Covid-19. Në këtë kuadër, për ta rritur qëndrueshmërinë në planifikim dhe financim, MPMS-ja dhe Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie në Asociacionin e Komunave të Kosovës kanë hartuar një model të Planit Komunal për Shërbime Sociale i cili do të shërbejë në harmonizimin e prioriteteve me



Buxhetin Vjetor dhe Kornizën Afat-Mesme Buxhetore. Planet Komunale për Shërbime Sociale janë instrument i rëndësishëm dhe mund t'i paraprijnë rritjes së koordinimit dhe efikasitetit në zbatimin e politikave të reja, siç është Granti i Veçantë për Shërbime Sociale

nëpërmjet Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Shërbimet Sociale. Granti i Veçantë për Shërbimet Sociale dhe Ligji për Shërbimet Sociale synojnë financimin e qëndrueshëm të shërbimeve sociale në nivel komunal bazuar në standardet minimale. Është

evidente që buxhetet publike duhet të sigurojnë mbështetje të përshtatshme financiare për ofrimin e shërbimeve sociale pasi kjo paraqet një investim efektiv dhe një element thelbësor në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Organizimi i kësaj punëtorie

është pjesë e komponentit për avancimin e politikave publike në nivelin lokal në kuadër të programit në "Mbështetje të Komunave më të Forta dhe më të Qëndrueshme (SSSM)", i financuar nga Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze në Kosovë.

Krasniqi thotë se qeveria e ka ndarë në dy faza ndihmën ndaj bizneseve

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur të premten në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger. Krasniqi e ka njoftuar ambasadorin për përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për t'i mbështetur bizneset për tejkalimin e sfidave që janë shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Krasniqi ka thënë se Qeveria e Kosovës e ka ndarë në dy faza ndihmën ndaj bizneseve e që,

sipas tij, faza e parë është pakoja emergjente fiskale, me qëllim të mbajtjes aktive të bizneseve, kurse faza e dytë rimëkëmbja ekonomike.

Ndërsa Weidinger i ka uruar ministrit Krasniqi detyrën e re, duke shprehur gatishmërinë e vendit të tij që të fuqizohen edhe më shumë marrëdhëniet Kosovë-Austri, veçanërisht në aspektin ekonomik.

Ambasadori ka thënë se e vlerëson shumë të rëndësishëm partneritetin në mes të Austrisë dhe Kosovës.



OAK-u kërkon nga MBPZHR-ja që të procedojë sa më parë Projektligjin për pyjet

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Diskutimi për plotësimndryshimin e udhëzimeve administrative të cilat tash e disa vite janë duke dëmtuar në shkallë shumë të lartë zhvillimin e sektorëve të bujqësisë, blegtorisë, turizmit dhe minierave, ishte qëllimi i takimit të përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa.

Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka përhëndetur iniciativën e ndërmarrë nga ana e ministrit Mustafa për



ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr.10/2010 me të cilin është rregulluar kufizimi i hapësirës prej 5 ha duke u rritur

në deri 20 ha si dhe kufizimi i kohëzgjatjes së licencave nga pesë vjet, rritet në përputhje me licencat e lëshuara nga KPMM-ja.

Njëkohësisht OAK-u ka kërkuar që të inicohet edhe ndryshimplotësimi i udhëzimeve të tjera të adresuara tash e një kohë te MBPZHR-ja e që kanë të bëjnë me uljen e kostos së qirasë nga 2 000 euro për ha në vit dhe të trajtohet çështja e sigurimeve bankare pasi që momentalisht bizneset detyrohen të paguajnë dy garanci të ndryshme bankare për të njëjtën hapësirë, duke iu krijuar shpenzime të dyfishta për

operatorët ekonomikë.

Ministri Mustafa ka falënderuar OAK-un për takimin dhe ka njoftuar se janë duke punuar që ta procedojnë Projektligjin për pyjet i cili do të trajtojë dhe zgjidhë shumë probleme të bizneseve, andaj është shprehur i hapur për të bashkëpunuar edhe më tej për krijimin e lehtësirave të operimit për bizneset.

OAK-u konsideron se kjo nismë do ta lehtësojë rrugëtimin tonë drejt zhvillimit ekonomik dhe do të krijojë kushte më të favorshme për investitorët e huaj, nisur nga pasuritë nëntokësore që ka shteti ynë.

ASK-ja tregon sa ka tokë bujqësore në Kosovë dhe me çka mbillet ajo

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës ka publikuar rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) për vitin 2019. Publikimi ofron të dhëna për shfrytëzimin e tokës bujqësore, kulturat bujqësore, blegtorinë dhe produktet blegtoriale, inputet bujqësore (plehurat minerale, organike, pesticidet), fuqinë punëtore në bujqësi dhe shpenzimet në ekonomitë bujqësore.

Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se në Kosovë sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420 141.05 hektarë (përfshirë tokën e përbashkët). Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, pjesa më e madhe u përket: livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) me 51.9 për qind; tokës së punueshme, ku arat marrin pjesë me 44.8 për qind; kulturat shumëvjeçare (pemët, vreshtat,

fidanët) me 3.0 për qind; dhe kopshtet me 0.3 për qind

Nga gjithsej tokë e punueshme - ara (188 364.69 ha), pjesa më e madhe është me drithëra 124 198.96 ha (65.9 për qind); bimë foragjere me 37 496.72 ha (19.9 për qind); perime gjithsej (në fushë të hapur, në serra dhe kopshte) janë 9 958.80 ha, prej të cilave perime në fushë të hapur dhe serra janë 8 836.68 ha (4.7 për qind); patate 3 688.19 ha (2.0 për qind); bishtajore 2 997.00 ha (1.6 për qind); bimë industriale 401.92 ha (0.2 për qind); kultura të tjera 2 580.42 ha (1.4 për qind) dhe tokë djerrinë 8 164.80 ha (4.3 për qind).

Sipërfaqe e ujitur, të paktën një herë gjatë periudhës referuese të anketës, është 31 899.99 ha, kurse gjithsej sipërfaqja e trajtuar me pesticide ishte 19 050.93 ha.

Sipas rezultateve të AEB 2019, numri i gjedheve ishte 257 733 krerë; i deleve ishte 189 102 krerë; i dhive ishte 27 197 krerë; i derrave ishte 40 538 krerë; i



njëthundrakëve (kuaj, mushka, gomarë) ishte 2 037 krerë; i shpezëve (pula, qura, rosa dhe pata) ishte 2 665 262 krerë; dhe

gjithsej numri i koshereve të bletëve ishte 219 831.

Përmes Anketës së Ekonomive Bujqësore janë grumbulluar të

dhëna rreth punës në bujqësi, varësisht nga angazhimi i tyre në prodhim, me orar të plotë, të pjesshëm (herë pas here).

Komuna e Podujevës kërkon nga qytetarët ta ruajnë ambientin

PODUJEVË, 26 QERSHOR (ER) - Me qëllim të mbrojtjes së ambientit dhe ruajtjes së shëndetit, Komuna e Podujevës ka bërë dije se do ta zbatojë rregulloren për menaxhim të mbeturinave, në të cilën, sipas

pikës 1 të nenit 6, thuhet: "Çdo gjenerues i mbeturinave është i obliguar të përfshihet në sistemin e menaxhimit të mbeturinave". Me këtë rast, Komuna e Podujevës ka apeluar te qytetarët që deri më

1 gusht 2020 të lidhin kontrata çdo amvisëri me kompanitë për menaxhim të mbeturinave KRM "Pastrimi" ose "Natyra" Sh. P. K., varësisht se cila kompani vepron në vendbanimin e tyre. "Pas 1 gushtit komuna

do të ndërmarrë masa ligjore ndaj të gjithë atyre që nuk do të kenë kontrata të lidhura me njërin nga kompanitë për menaxhimin e mbeturinave", ka njoftuar Komuna e Podujevës.



Bekim Jashari vazhdon vizitat te familjet e dëshmorëve

SKENDERAJ, 26 QERSHOR (ER) - Në shenjë nderimi e falënderimi për kontributin dhe sakrificën e jashtëzakonshme, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku dhe drejtorin e Kulturës, Abdyl Ymeri, të premtën kanë vazhduar vizitat te familjet e dëshmorëve me rastin e 21-vjetorit të çlirimit të Komunës së Skenderajt. "Ashtu siç edhe kemi planifikuar, që ta shënojmë 18 qershorin, gjatë vizitës te këto familje dhuroam mirënjohje për dëshmorët: Bashkim I. Kerolli, Driton G.

Veliu, Fehmi Kerolli, Shefqet S. Kerolli, Liman S. Koca, Naim H. Xani, Xhemë M Veliu, Xheladin J. Kabashi dhe Samit B. Veliu, të cilët nuk kursyen as jetën e tyre për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", ka thënë Jashari.

Më tutje, ai ka thënë se familjet e dëshmorëve janë nderi dhe historia jonë e lavdishme. "Ato duhen trajtuar me kujdes të veçantë dhe respekt të vazhdueshëm për kontributin e tyre për jetësimin e idealeve tona shekullore. Vizitat te familjet e dëshmorëve vazhdojnë ditët në vijim", ka thënë Jashari.



Ismajli kujton ditën e themelimit të pikës së UÇK-së në Rancë të Shtimes



SHTIME, 26 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, me rastin e 22-vjetorit të themelimit të Pikës së UÇK-së në Rancë, ka uruar këtë ditë për të gjithë ata që kontribuuan në luftën për lirinë. "Kam nderin që sot në këtë ditë të kujtojmë e t'iu përulemi veprës dhe jetës së gjithë atyre dëshmorëve të cilët kanë dhënë jetën për çlirimin e vendit tonë e të cilët sollën lirinë e shumëpritur nga të gjithë ne. Ju qoftë lavdi!", ka thënë Ismajli.

Ai ka pohuar se nga kazerma e

Rancës kanë dalë shumë veprimtarë dhe dëshmorë që kanë dhënë jetën për lirinë e Kosovës. "Jemi me fat që kemi dy objekte me rëndësi kulturore-historike, Shtabin e UÇK-së në Rancë dhe atë në Pjetërshicë, i cili është në përfundim të renovimit. Kanë qenë dy kazerma, dy vende ku pjesëtarët e UÇK-së kanë kaluar çaste të mira e të lira. Nga kazerma e Rancës kanë dalë shumë veprimtarë dhe dëshmorë që kanë dhënë jetën për lirinë e Kosovës", është shprehur Ismajli.

AQH-ja zvicerane vazhdon ta mbështesë me projekte shëndetësinë në Mitrovicë

MITROVICË, 26 QERSHOR (ER) - Drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani dhe drejtori i QKMF-së "Dr. Nexhat Çuni" në Mitrovicë, Fevzi Sylejmani, kanë pritur të premtën në një takim përfaqësuesit e organizatës zvicerane Accesible Quality Healthcare (AQH), Bajram Maxhuni dhe Qamile Ramadani.

Qëllimi i këtij takimi ishte përkrahja e projekteve që ndikojnë në përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë së shër-

bimeve shëndetësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mitrovicë dhe në rrjetin institucional.

Me këtë rast, përfaqësuesit e AQH-së kanë potencuar se do ta vazhdojnë përkrahjen e shëndetësisë në Mitrovicë në projekte të ndryshme dhe një ndër projektet do të jetë përmirësimi i rrjedhjes së pacientëve, ku do të bëhet digjitalizimi i terminëve të pacientëve në QKMF dhe ordinancave në

mjekësinë familjare, që hyjnë në kuadër të pikës së ofrimit të shërbimeve më të mira shëndetësore.

Ndërsa drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj Barani, ka falënderuar dhe vlerësuar lart kontributin e AQH-së për realizimin me sukses të të gjitha projekteve paraprake si dhe për vazhdimin e projektit në fjalë që ka për qëllim përkrahjen e sektorit të shëndetësisë për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore.



PSE TANI?



Bedri ISLAMI

Vështirë se në jetën politike të Hashim Thaçit do të ketë pasur një çast më të vështirë jo që është pjesë e aktakuzës së prokurorit të specializuar, që u bë e njohur derisa ai po nisej në Shtetet e Bashkuara, ku është menduar të pritët në Shtëpinë e Bardhë, por pikërisht se, në këto çaste, kur do të nisë fillimi i një zgjidhje radikale e, ndoshta, përfundimtare në të mirë të Kosovës, atij do t'i duhet të vendosë për gjëra që ndërthuren me të ardhmen e vendit të tij. Nëse prokurori i specializuar do të kishte dashur të gjente një kohë më të rëndë, edhe sikur me vite të kishte pritur, ai nuk do të kishte mundur ta gjente. Më shumë sesa një fillësë akuze, e cila edhe mund të hidhet poshtë nga Dhomat e Specializuara, është një ngarendje për të vendosur nën pushtetin e trysnisë njërin ndër njerëzit që deri më tani, duan apo nuk duan në Kosovë, është pjesë e frytshme e disa proceseve, të cilat lidhen me lirinë e Kosovës, pavarësinë e saj dhe kthimin përfundimtar të rrugës së vendit të tij drejt Perëndimit.

Ka më shumë se dy muaj e gjysmë që prokurori i Specializuar e ka dërguar lëndën e tij tek Dhomat e Specializuara dhe ka më shumë se një vit kur, të rënduar nga kjo ndjekje e vazhdueshme, trysni dhe presion politik dhe juridik mbi disa nga figurat më të rëndësishme të Kosovës, disa nga autoritetet kërkuan përfundimin e mandatit të Gjykatës së Specializuar që lidhet me krimet e supozuara të luftës dhe pasluftës në Kosovë dhe, që atëherë, jo vetëm që nuk është bërë asnjë veprim drejt shuarjes së kësaj gjykate, ku vetë Thaçi ishte nismë e miratimit, por, ndërkohë janë thirrur si dëshmitarë apo nën hetim më shumë se 200 pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Disa nga të cilët janë pyetur me ditë e net dhe në Kosovë asnjë institucion nuk ndërmori diçka kundër Dhomave të Specializuara apo Prokurorit Special.

Nëse Hashim Thaçi, Kadri Veseli apo të tjerë janë pjesë e krimet të ndodhur në Kosovë, gjithnjë nëse ka pasur krime, kjo do të jetë e sqaruar në javët, muajt e ndoshta vitet e ardhshme.

I gjithnjë njoftimi publik është ndërtuar për të shpallur fajtorë ende pa u gjykuar një trupë drejtuese të luftës, të cilët, në

momentet më të vështira, morën përsipër drejtimin e luftës në Kosovë, ku edhe mund të vriteshin, të cilëve, në shumë raste iu vranë nga hordhitë serbe, të afërmit e tyre, njerëzit e gjakut dhe bashkëluftëtarët.

Përse është ndërtuar jo si aktakuzë por si aktgjykim, sidomos si akt përfundimtar për dënimin e një elite politike e ushtarake drejtuese?

“Në Aktakuzë - ka shkruar prokurori i Specializuar pretendohet se Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe të dyshuarit e tjerë janë penalisht përgjegjës për afërsisht 100 vrasje të paligjshme. Krimet e paraqitura në aktakuzë përfshijnë qindra viktima të identifikuar shqiptarë, serbë dhe romë të Kosovës dhe kundërshtarë politikë”.

Prokurori i Specializuar, menjëherë pas emrave të Thaçit dhe Veselit, pa shtuar asnjë tjetër, shton fillimisht numrin e 100 vrasjeve të paligjshme dhe, pak më pas, qindra viktima, duke ngjallur, si ai vetë e ka menduar se do të ndodhë, se kemi të bëjmë me një rast të stërrënduar, ku dy drejtuesit kryesorë të luftës bartin mbi vete afërsisht 100 vrasje e pastaj qindra viktima të tjera.

Rëndesa e mjedisit politik dhe paragjykimi, përmes padisë penale, e cila, si thotë Prokurori i Specializuar mund të provojë të gjitha akuzat jashtë dyshimit të arsyeshëm, është po ashtu një trysni mbi Dhomat e Specializuara dhe sidomos mbi gjykatësin, i cili do të vendosë nëse akuzat janë të arsyeshme apo jo dhe këtë nuk mund ta shpallë botërisht, ende pa filluar asnjë proces i mirëfilltë vetë ai që ka ngritur akuzën.

Më shumë se sa një dëshmi, njoftimi i prokurorit të

Specializuar është një deklaratë politike, e cila mban datën 24 qershor, por që është bërë e gatshme që në muajin prill.

Është një deklaratë pa precedent në praktikën e institucioneve të drejtësisë së pavarur, shkelje e rëndë e parimeve themelore të drejtësisë dhe duket si e dalë nga dora e Karla del Pontes, njëra nga kundërshtarët më të ndjeshme të luftës në Kosovë, ndjekëse e pasionuar për dënimin e shqiptarëve, që nganjëherë kalonte në dëlir dhe që kishte shpallur që në fillim, me veprimet e mosveprimet e saj, amnistinë e krimet serb në Kosovë.

Përse tingëllon e gjitha si një deklaratë politike?

Si ka vërejtur me të drejtë politologu i njohur Bardhyl Mahmuti, ish-ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës dhe autori i librit të madh denoncues, “Mashtrimi i Madh”, ku të shpallurit të vranë jetojnë të qetë në Serbi, në njoftimin e prokurorit special është nëpërkëmbur parimi i parë dhe kryesor i drejtësisë që nuk është e varur nga politika dhe qëndron në Parimin e Supozimit të Pafajësisë, për deri sa nuk shpallet fajtor nga Gjykata.

Prokurori Special duhet ta dijë këtë fare mirë. Në mos tjetër, këtë e ka mësuar që në fillimet e karrierës së tij, e megjithatë, ndoshta i mëritur nga fakti se ka ende në mendje tentimin për zhbërjen e kësaj strukture, bën të kundërtën. Ai shpall fajtor të akuzuarit prej tij, duke u bërë në të njëjtën kohë edhe gjykatës.

Ai, jo vetëm që nuk pret vendimin e gjykatës, por ende pa u miratuar aktakuza nga Dhomat e Specializuara, të cilat bëjnë hapin e parë të pranimit të akuzës. Zyra e Prokurorit të Specializuar, përmes një deklaratë thellësisht

politike, shpall, ndër të tjera, se “Prokurori i Specializuar e gjykon të domosdoshme nxjerrjen e këtij njoftimi publik për akuzat, për shkak të përpjekjeve të përsëritura të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit për pengimin dhe sabotimin e Dhomave Speciale të Kosovës duke ndërmarrë në fshehtësi një fushatë për shfuqizimin e ligjit të krijoj gjykatën dhe nëpërmjet këtyre veprimeve Thaçi dhe Veseli kanë vënë interesat e tyre vetjake mbi viktimat e krimeve të tyre, sundimin e ligjit dhe popullin e Kosovës.”

Megjithëse procesi gjyqësor nuk ka filluar ende dhe Dhomat e Specializuara ende nuk i kanë pranuar akuzat e prokurorit, pra, ende pa filluar procesi gjyqësor, Zyra e Prokurorit të Specializuar shpall vendimin dhe i cilëson Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin si kriminelë dhe i paragjykon se “qindra viktima të identifikuar shqiptare, serbë dhe romë qenkëshin viktima të krimeve të tyre”.

Si e cilësova, që nga ditët kur gjykata Speciale po zvarriste pafundësisht proceset dhe ishte drejtuar thellësisht vetëm ndaj krimeve të supozuara të shqiptarëve ndaj pakicave të thera apo të quajturve bashkëpunëtorë të shërbimit sekret serb, kanë kaluar kaq shumë muaj, proceset po vazhdojnë normalisht, janë thirrur dhe vazhdojnë të japin dëshmitë e tyre apo të hetohen të tjerë ish luftëtarë dhe asgjë nuk ka të bëjë me pretendimin e supozuar të prokurorit për pengimin apo, edhe më tej, sabotimin e Gjykatës Speciale, e cila u ngrit në sajë të këmbënguljes së Thaçit, si një linjë e mundshme për pastrimin e emrit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Sidoqoftë ankthi i pritjes po shkon

drejt shuarjes së enigmës. Prej kaq muajve në Kosovë flitej, hamendësohej, dyshohej, përgojohej, hetohej se kush do të ishte në gjakimet e ardhshme dhe se cilët kishin bërë kompromise të dhimbshme në dëm të Kosovës. Hashim Thaçi ishte më i përfoluri nga të gjithë, jo vetëm se ishte kryeministër apo president, por edhe për rolin e tij në luftë, në bisedimet e vështira politike etj. Ai, shpesh herë, nga ata që sot u gëzuan pa masë nga njoftimi, është cilësuar si njeriu që shiti Kosovën si marrëveshje të fshehtë për të shkuar në Hagë. Kishin shkuar edhe më tej, duke bërë thirrje cinike “shko, bre Hashim në Hagë”, e kanë akuzuar dhunshëm, edhe në Kuvendin e Kosovës nga opozita e dhunshme se, ai e ka shitur Kosovën për të siguruar veten, se mes tij dhe ndërkombëtarëve ka një marrëveshje të fshehtë, përmes së cilës Thaçi do të bëjë kompromise që të mos shkojë në Gjykatën Speciale etj.

Jam i bindur se jo të paktë kanë fërkuar duart: veti kjo e shqiptarëve të “ndershëm”, si i cilësonte dikur Beogradi.

Tani duhet të jenë të bindur se kurrfarë marrëveshje nuk ka pasur mes tij dhe hetuesve apo forcave politike të huaja. Duhet të binden edhe më tej se ai, si shumë të tjerë, padrejtësisht apo jo, do të mund të dënohet, por kompromis shpirtzi nuk ka pasur. Tani gjithkush mund të jetë i qetë se njeriu i akuzuar prej tyre se po shet Kosovën për të ruajtur kokën e pasurinë e tij, është një nga të shumtët që do të përballen me Gjykatën Speciale.

Është momenti më i vështirë i Thaçit. Kur jemi takuar në marsin e këtij viti, ai e dinte se mund të ndodhte diçka e tillë, por ishte i qetë, si gjithë ata që e kanë bërë detyrën e tyre.



Zyrtari i OBSH-së paralajmëron: Vala e dytë e Covid-19 do t'i mbytë miliona veta

NJU JORK, 26 QERSHOR - Miliona njerëz do të vdesin nëse pandemia Covid-19 do të kthehet me një valë të dytë infektimesh, ka paralajmëruar të premtën një zyrtar i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, duke shtuar se pandemia vdekjeprurëse deri

më tani është zhvilluar ashtu siç kishte paralajmëruar OBSH-ja. "Krahasimi është me gripin spanjoll që është zhvilluar saktësisht si Covidi; u dobësua në verë dhe u rikthye ashpërsisht në shtator dhe tetor, duke shkaktuar 50 milionë

viktima gjatë valës së dytë", thotë Ranieri Guerra, ndihmësdrejtor i përgjithshëm i iniciativave strategjike. Ai ka theksuar se gjenoma e virusit nuk ka ndryshuar. Komentet e Guerrës vijnë ndërsa disa shtete në Evropë dhe në pjesë të tjera të globit

kanë filluar t'i zbusin masat kombëtare të kufizimit, të ndërmarra fillimisht për ta kufizuar përhapjen e virusit. Sipas Guerrës, një nga armët që mund të përdoret për të përballuar më mirë një valë të dytë është vaksinimi kundër gripit.



Rekord i ri i të infektuarve me Covid-19 në ShBA

NJU JORK, 26 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar të premtën numër rekord të të infektuarve nga Covid-19, mbi 40 000. Rekordi i mëparshëm në ShBA, i regjistruar nga ky institucion, ka qenë më 24 prill me 36 400 raste të reja, ndonëse atëkohë janë bërë më pak teste.

Shtetet e Bashkuara kanë konfirmuar gjithsej mbi 2.4 milionë të infektuar me koronavirus dhe mbi 122 370 viktima - më shumë se çdo

vend tjetër në botë.

Zyrtarët shëndetësorë në ShBA vlerësojnë se numri real i rasteve ka të ngjarë të jetë dhjetë herë më i lartë se shifra e raportuar. "Llogaritja jonë më e mirë është se për çdo rast që është raportuar kanë qenë edhe dhjetë të infektuar të tjerë", ka thënë drejtori i Qendrës për Kontrollin e Sëmundjeve në ShBA, Robert Redfield.

Ai ka theksuar se 5-8 për qind e popullsisë i është ekspozuar




virusit dhe u bëri thirrje amerikanëve që ta mbajnë distancën fizike, të vendosin maska dhe t'i lajnë duart.

Parashikimet e Universitetit të Uashingtonit janë që numri i viktimave në ShBA të arrijë deri në 180 000 deri në tetor, ose në 146 000 nëse amerikanët mbajnë maska.

Në gjithë botën, koronavirusi ka prekur mbi 9.6 milionë njerëz. Prej tyre, mbi 4.8 milionë janë shëruar, ndërsa afro 490 000 kanë vdekur.

Reja e pluhurit saharjan mbërrin në ShBA e Meksikë, ekspertët japin alarmin



NJU JORK, 26 QERSHOR - Një re masive pluhuri që vjen nga shkretëtira e Saharasë në Afrikë ka mbërritur në qytetet bregdetare amerikane dhe të gadishullit Yucatan të Meksikës. Reja e pluhurit të Saharasë përshkroi tre mijëra kilometra nga Afrika e Veriut përpara se të mbërrinte në Karaibe e tashmë në Meksikë. Studiues i Qendrës Kombëtare të Shkencave Atmosferike të Universitetit Autonom të

Meksikës, Antonio Ladino, u bëri thirrje banorëve të vendosin maska për t'i parandaluar problemet me frymëmarrjen. Ai tha se gjëllitja e një sasive të madhe pluhuri mund të ketë pasoja shumë të rrezikshme për shëndetin.

Ekspertët thonë se pluhuri i dendur do të qëndrojë mbi Meksikë dhe pjesën juglindore të Shteteve të Bashkuara, përfshirë Floridën, deri në

mesin e javës tjetër. Prania e resë të pluhurit në Florida mund të jetë tejet problematike, ndërsa shteti po përjeton një rritje të rasteve të Covid-19.

Njerëzit me probleme të shëndetit janë inkurajuar t'i shmangin aktivitetet në natyrë. Autoritetet shëndetësore thonë se pluhuri mund të jetë veçanërisht i dëmshëm për njerëzit me sëmundje të frymëmarrjes dhe zemrës.

Dhoma e Përfaqësuesve në ShBA miraton projektligj për reformën në polici

UASHINGTON, 26 QERSHOR - Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara miratoi një projektligj për reformën në polici, por ai ka pak gjasa të bëhet ligj për shkak të ndarjeve të thella. Dhoma e kontrolluar nga demokratët e votoi masën me 236 vota për dhe 181 kundër. Projektligji është emëruar sipas George Floydit, afrikano-amerikanit që ka vdekur muajin

e kaluar gjatë arrestimit nga policia.

Vdekja e tij ka shkaktuar protesta kundër racizmit në gjithë botën.

Por, presidenti amerikan Donald Trump, i cili vjen nga Partia Republikane, ka paralajmëruar se do të vendosë veto mbi ligjin. Ndërsa republikanët në Senat janë duke hartuar ligjin e tyre për

reformimin e policisë.

Floyd ka vdekur më 25 maj në qytetin Minneapolis. Incidenti është filmuar nga kalimtarët dhe është shpërndarë në mediat sociale. Në incizime shihet se si një polic i bardhë e shtyp me gju Floydin, për gati nëntë minuta. Pak më vonë, ai vdes. Floyd është ndaluar nën dyshimet se ka krijuar një faturë të rreme në vlerë prej 20 dollarësh.



Greqia dhe Turqia diskutojnë për pandeminë, por jo edhe çështjet politike

Athinë, 26 qershor - Kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis dhe presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan zhvilluan të premtën një bisedë telefonike, gjatë së cilës diskutuan për ndikimin e pandemisë së Covid-19, njoftoi zyra e kryeministrit grek.

Greqia dhe Turqia komunikojnë shumë rrallë për shkak se kanë kundërshtime për një sërë çështjesh dypalëshe.

Erdogan dhe Mitsotakis adresuan mënyrat për t'i trajtuar efektet e shpërthimit të koronavirusit, rihapjes së kufijve dhe turizmit, thuhet në një

deklaratë nga zyra e Mitsotakis. "Mitsotakis dhe Erdogan u pajtuan t'i mbajnë kanalet bilaterale të komunikimit", u tha në njoftim.


Një burim, i tha agjencisë "Reuters" se "të dy udhëheqësit nuk diskutuan çështjet politike, por ata ranë dakord se ten-

sionet mes dy vendeve janë të larta dhe se kanalet e komunikimit duhet të rikthehen".

Mosmarrëveshjet në mes të Turqisë dhe Greqisë kanë të bëjnë kryesisht për të drejtat e hapësirës ajrore, kufijtë detarë, migrantët dhe Qipron e ndarë etnikisht.



NËSE BOTËN DO TA SUNDOJA UNË...



Nga: Umberto ECO

Mund të jap vetëm një përgjigje polemike, për atë që unë do të bëja nëse do të sundoja botën, për shkak se nuk ka shanse që kjo të ndodhë. Duke u plakur kam filluar ta urrej njerëzimin, kështu që po të kisha patur pushtet absolut, do ta lija të vazhdonte në rrugën e vetëshkatërrimit – kështu ai do të shkatërrohej dhe unë do të isha më i lumtur.

Njerëz si unë, intelektualë – bëjmë punën tonë, shkruajmë artikuj, kemi mënyrat tona të të protestuarit, – s'mund ta ndryshojmë botën. Angela Merkel bëri një deklaratë pozitive, kur nxiti popullin gjerman që të mirëpresë refugjatët siri-anë. Ajo ndryshoi imazhin e popullit gjerman në të gjithë botën – ata nuk do të shihen më si SS-ët e Adolf Hitlerit. Këtë mund të bëjnë politikanët.

Të rinjtë duhen mësuar që të filtrojnë dhe të shtrojnë pikëpyetje mbi informacionin që marrin përmes Internetit, në vend se ta pranojnë atë për të vërtetë. Unë

e përdor Wikipedian dhe e di se mund t'i besoj asaj 99 për qind të kohës, por njerëzit kanë shkruar në faqen time se kam qenë i pari i 13 fëmijëve dhe se jam martuar me bijën e botuesit tim të parë. Asnjë prej këtyre nuk është e vërtetë, kështu që edhe kjo mund të bëhet objekt manipulimi.

Një prej nipërve të mi është 15 vjeç dhe ai më thotë se shumë prej bashkëmohatarëve të tij u besojnë teorive konspirative që lexojnë në internet. Nuk ka kontroll cilësie – dhe ky është problem shumë i madh.

Çdo qeveri duhet të përpiqet të përmirësojë arsimin. Përpara Luftës së Parë Botërore, vetëm rreth 20 për qind e njerëzve në Itali merrnin arsim fillor. Sot, problemi janë universitetet – rreziku është që të reduktojmë kërkesat e hyrjes, me qëllim që t'u japim më shumë njerëzve qasje në universitet, por edhe të kemi cilësi më të ulët. Ndodhi kohët e fundit në Itali dhe ishte një tragjedi. Tani tre vitet e parë të universitetit janë shumë të kollajtë – studentëve nuk u duhet të lexojnë libra më

shumë se 100 faqesh. Ata që kanë pushtet duhet të kuptojnë se, që të rritesh, duhet të sfido-hesh. Kur unë isha në universitet, lexoja një mijë faqe dhe nuk vdisja!

Mësimi i gjuhëve të huaja është e vetmja gjë që unë do ta bëja të detyrueshme në shkollë. Në qoftë se koncepti i Evropës ekziston, atëherë ai është i bazuar në njohuritë e ndërsjella të gjuhëve. Në dy prej vendeve më të mëdha, Francës dhe Anglisë, shumica e njerëzve duket se dinë vetëm gjuhën e tyre. Jo shumë kohë më parë, në Angli, njerëzit ishin mësuar të flisnin rrjedhshëm në gjuhën latine. Ekziston një histori e një gjenerali anglez, i dërguar në krahinën indiane të Sindh në shekullin e XIX-të, gjatë një revolte. Për shaka, ai dërgoi një telegram në Londër në latinisht, ku shkruante "Peccavi," që përkthehet "Kam mëkatuar." Gjëja e mrekullueshme nuk ishte se ai mund të bënte shaka në latinisht, por se kolegët e tij në Londër e kuptuan.

Nipi im ka studiuar greqisht për dy vitet e fundit; ai mund të

mos jetë në gjendje që të lexojë Homerin në original, por ka zhvilluar një kuptim të qytetërimit grek. Është një pjesë e asaj që është quajtur "encycloios", e cila do të thotë "arsim 360 gradë", prej nga vjen edhe fjala "enciklopedi".

Njerëzit janë kafshë fetare. Qentë nuk janë fetarë. Është e vërtetë se ata i lehin Hënës, por kjo ndoshta nuk ndodh për shkak të fesë. Njerëzit kanë tendencën për të kërkuar arsyen e situatave të tyre. Ka një fjali të bukur që i atribuohet GK Chestertonit: "Kur njerëzit nuk besojnë më në Zot, kjo nuk ndodh për shkak se ata nuk besojnë në asgjë; ata besojnë në çdo gjë!"

Sundimtari i botës nuk mund ta eliminojë fenë. Ju mund të jeni një ateist apo një jobesimtar, por ju duhet të pranoni se pjesa më e madhe e njerëzve kanë nevojë për disa besime fetare. Karl Marksi thoshte se feja është opiumi i popullit – se ajo i mban njerëzit të qetë. Por, ajo mund të jetë gjithashtu kokaina e popullit. Ajo ka funksion të dyfishtë – t'u përgjigjet pyetjeve të cak-

tuara themelore dhe ndonjëherë duke i shtyrë ato, për të luftuar jobesimtarët. Ky është një tipar i njerëzimit, po aq sa edhe ai që i bën njerëzit të jenë të vetmet specie të aftë për të dashuruar.

Së fundi, në qoftë se unë do të isha sundimtar i botës, do të doja të detyroja njerëzit për të lexuar të gjithë librat e mi, në mënyrë që të bëhen aq të zgjuar sa unë dhe kështu të mos besonin, se ne duhet të kemi një sundimtar në këtë botë! Jam i irrituar nga kritikën pozitive, nëse ato janë pozitive për arsye të gabuara. Dhe, ndonjëherë jam i prekur nga kritikën negative, sepse ata e shohin që unë kam kuptuar diçka të vërtetë. Ndonjëherë jam i irrituar nga një kritikë negative, sepse unë mendoj se është idiote, por OK, kjo është pjesë e lojës. /Bota/

(Pjesë nga një intervistë e shkrimtarit, kritikut letrar, filozofit dhe profesorit Umberto Eco, dhënë për gazetaren Serena Kutchinsky të revistës britanike "Prospect", në dhjetor 2015)

E rrallë

U fut në kishë pa maskë, gjobitet kryeministri i Bullgarisë

Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borisov, u gjobit me një shumë prej 153 eurosh pasi u fut në një kishë pa maskë. Këtë e ka bërë me dije ministri i Shëndetësisë, Kirill Ananiev. Për "Reuters", ai tha se të gjithë të pranishmit në kishë gjatë vizitës së kryeministrit do të gjobiten.



FOTO E DITES



Qytetarët në Singapor respektojnë masat anti-Covid. /Reuters/

E jashtëzakonshme

Japonia shpik maskën që përkthen në tetë gjuhë të botës

Quhet "C-maskë" dhe lidhet përmes Bluetoothit me një aplikacion smartphone dhe tablete që mund të transkriptojë mesazhe me tekst, të bëjë thirrje ose ta amplifikojë zërin e mbajtësit të maskave. Deri më tani interesimi për maskën që kushton 40 dollarë ka qenë i madh.



BARSOLETA E DITËS



Djali: Zemër, ta kam blerë një dhuratë për ditëlindje.
Vajza: Uaaaa çfarë befasi!
Djali: E sheh atë 'Ferrarin' me ngjyrë të kuqe.
Vajza: Të dua shpirt pa fund.
Djali: Si ajo ngjyrë e veturës ta kam blerë një bluzë.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

Modelja shqiptare sjell fotosesion sensual nga Amerika

Për momentin është njëra prej modelëve shqiptare më të kërkuara në Amerikë. Bëhet fjalë për Lorena Halitin e cila këto ditë ka mbajtur disa fotosesione në Amerikë. I tillë është edhe fotosesioni i fundit i Lorenës në të brendshme e ku bukuroshja kosovare

tregon potencialin e saj. Ajo shfaqet në të brendshme të zeza derisa tregon vetëm pak nga ky fotosesion derisa ka edhe një cigare në gojë. Lorena ka qenë aktive edhe gjatë pandemisë COVID-19, por tani ajo ka filluar të jetë edhe më aktive.



 <p>DASHI Sot më shumë se asnjë ditë tjetër keni për të qenë kundër mendimeve dhe veprimeve të personave që ju rrethojnë.</p>	 <p>DEMI Nuk keni për ta vrarë mendjen shumë për problemet që keni sepse doni t'ia dedikoni vetëm argëtimit tuaj.</p>	 <p>BINJAKËT Gjëja më e mirë që mund të bëni është të mendoni për të ardhmen tuaj. Duhet të bëni plane afatgjata si për familjen ashtu edhe për punën tuaj.</p>	 <p>GAFORRJA Çdo gjë që ju do të bëni ka për t'ju ecur mbarë. Jeni në kulmin e energjive tuaja pozitive dhe duhet të shfrytëzoni këtë moment.</p>	 <p>LUANI Edhe pse nuk jeni shumë të zotët t'i zgjidhni problemet tuaja sentimentale, keni për të bërë të pamundurën për të ndryshuar, aq sa dhe partneri juaj ka për t'u habitur shumë.</p>	 <p>VRIGJËRESHA Pasionet tuaja kanë për të bërë që të humbni shumë kohë. Ju këshillojmë të qëndroni më afër dhe të shpenzoni më shumë kohë me familjarët të cilët e ndiejnë mungesën tuaj.</p>
 <p>PESHORJA Familja do të jetë në mendimet tuaja, edhe pse nuk dini se si do të reagojnë pasi ju të flisni me ta për një problem tuajin.</p>	 <p>AKREPI Sigurisht, dita e ka për të qenë në favorin tuaj. Keni për të qenë shumë romantik, pasi keni zbuluar që partnerit tuaj i pëlqen më shumë kur jeni të tillë sesa kur i impononi gjërat që duhet të bëjë.</p>	 <p>SHIGJETARI Që në mëngjes keni për të vënë re se dita do të jetë shumë e ngadaltë dhe do të keni frikë se mos nuk përfundoni dot planet që keni për veten dhe miqtë.</p>	 <p>BRICJAPI Përpara se të merrni vendime të rëndësishme, mundohuni ta kërkonit këshillën e personave që gjithmonë ju këshillojnë për mirë.</p>	 <p>UJORI Do të keni kohë të lirë për t'iu dedikuar atyre gjërave që zakonisht ua lini të tjerëve për t'i përfunduar. Kujdes se si do të flisni kur të jeni me shoqërinë tuaj.</p>	 <p>PESHQIT Keni për të kaluar një ditë normale, që mund të ndryshojë nga çasti në çast. Kujdes me shpenzimet e tepruara dhe me gjërat që realisht nuk i keni të domosdoshme.</p>

Dhurata Dora zbulon datën e publikimit të këngës së re



Dhurata Dora, si shumë prej kolegëve të veta të estradës, po sjell këngë të re për fansat. Përmes një videoje të shkurtër këngëtarja bëri të ditur se kjo këngë publikohet më 27 qershor. Si në

videoklipet e tjera, edhe kësaj radhe Dhurata shfaqet me një stil të veçantë në skena të ndryshme. Kujtojmë se projekti i fundit muzikor nga Dhurata Dora është "Lass Los" në bashkëpunim me Azetin.




Pas pandemisë, Rita Ora i kthehet mikrofonit

Rita Ora kohën e karantinës e kishte shfrytëzuar vetëm për relaksim, pasi të gjitha veprimtaritë muzikore i kishte pezulluar deri më tani. Këngëtarja me prejardhje shqiptare me anë të disa postimeve të

bëra së fundmi në rrjete sociale ka paralajmëruar rikthimin e saj në muzikë. Ajo gjatë orëve të vona ka ndarë një imazh nga studio e saj muzikore në Londër, ku shihet duke punuar për projektin e ri muzikor.

Shakira tregon figurën e saj të jashtëzakonshme trupore



Shakira, 43 vjeçe, shfrytëzoi pushimet në Barcelonë bashkë me fëmijët e saj Sasha dhe Milan, shkruan "Daily Mail". Këngëtarja nga Kolumbia u paraqit me rroba të

zhytjes të cilat i theksonin asaj vijat trupore për çfarë ajo shquhet. Muaj më parë ajo së bashku me Jennifer Lopezin u bënë kryetëmë e mediave për paraqitjen e tyre në "Super Bowl".

'Si përpara', titullohet kënga më e re e Butrint Imerit



Siç ishte paralajmëruar edhe më parë, Butrint Imeri ka publikuar këngën e tij më të re. "Si përpara" mban titullin kënga e re e tij të cilën e publikoi edhe me një videoklip

mjaft interesant të xhiruar në bregdet. Teksti është i shkruar nga Butrinti, Nuke dhe Big Bang, të cilët së bashku prodhuan një projekt mjaft ritmik.



Fatos Kongoli: Kapitulli i Amerikës

(Fragment nga romani, Botimet Toena, 2020)

Një ndër shqiptaro-amerikanët më të shquar, që Rastësia e gjithëfuqishme e sollti ta takoja atje, ku ajo më gatiste kurdoherë befasitë e saj, në një aeroport, është zoti Shpëtim Telegrafi, autoritet shkencor në fushën e mjekësisë, i nderuar dhe i vlerësuar lart në SHBA dhe kudo nëpër botë.

Unë nuk e njihja zotin Telegrafi. Si doli, ai njihej me vëllanë tim Rolandin, dhe me kushëririn tim të parë, Engjëll Kongolin, në vitet kur kishte punuar në Elbasan njëkohësisht me ata të dy. Këtu po ia lejoj vetes t'i largohem pak temës, të hap një parantezë; gjej rastin, më në fund, të them dy fjalë për kushëririn tim të ndjerë, Engjëll Kongolin. Pa e ditur as ai vetë, Engjëlli ka ndikuar jo pak në formimin tim, si shembull i njeriut të aftë e të talentuar.

Kur e kam ndeshur për herë të parë Engjëllin, nga mesi i viteve '50 të shekullit të kaluar, ne banonim ende te shtëpia dykatëshe prej qerpiçi përballë ish-Shtëpisë së Oficerëve (më pas Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve), që e kam përshkruar te romani "Kufoma". Engjëlli sapo ishte kthyer nga Hungaria, ku kishte qenë student për mjekësi. Më e saktë është të thuhet se sapo e kishin kthyer, për shkak të ndërprerjes së studimeve. Dëgjoja të thuhej se arsyeja që ia paskëshin ndërprerë studimet kishte qenë, ndër të tjera, një marrëdhënie dashurie e tij me

vajzën e ambasadorit amerikan në Budapest! Tani mendoj se në atë kohë, ky fakt mjaftonte që ai të shihej nga të gjithë si "delja e zezë". Por unë sapo kisha shkëlur në adoleshencë, ndërsa Engjëlli i përkiste botës së të rriturve. Për më tepër, unë ende nuk e dija kuptimin e metaforës "delja e zezë", për të përfytyruar mirëfilli ç'po i ndodhte atij. Gjatë atyre ditëve që bujti te ne, unë thjesht e shihja me një lloj kërsërie.

U miqësova me Engjëllin në një kohë tjetër, në vitet '68-'69, në qytetin tonë të lindjes, në Elbasan. Ai punonte si mjek radiolog në ambulancën e qytetit, unë në gjimnazin "Dhaskal Todhri". Kërsëria ime ndaj tij mbetej po ajo e dikurshme, kur kishte bujtur në shtëpinë tonë. Nuk e teproj po të them se ai ishte për mua një personazh i jashtëzakonshëm. Jo se e shihja me syrin e shkrimtarit, si protagonist të ndonjë prej romaneve të mia të ardhshme. Në atë kohë unë vërtet kisha filluar të botoja ndonjë tregim, por isha ende një letrar i ri, as që më shkonte nëpër mend se do të shkruaja romane. Aq më pak ta shihja Engjëllin si protagonist. "Delja e zezë" e dikurshme dilte jashtë skemave të kohës. Mbi të gjitha, unë ende nuk e njihja letërsinë e vërtetë, objektin e saj. Dhe, pavarësisht disa muajve shërbimi si mësues në një fshat të thellë malor të Elbasanit, ku hasa pamje krejt të ndryshme të realitetit, nga ato që

jepeshin përmes propagandës së ditës, isha i papërvojë, pra nuk njihja as jetën. E, megjithatë, këto nuk më penguan që ta shihja Engjëllin si një personazh të jashtëzakonshëm.

Takimet me të në Elbasan, më përfitonin një kënaqësi të vërtetë. Përveçse mjek i shkëlqyer radiolog, siç e pohonin të gjithë, ai ishte mjaft i kulturuar, gllabërues librash, njohës i disa gjuhëve të huaja, të cilat i fliste rrjedhshëm. Një talent i vërtetë. Ai gjithmonë kishte shkëlqyer, edhe në Budapest, si student, ku ia kishin ndërprerë studimet, edhe në Tiranë, ku i kishte përfunduar. Dikush tjetër në vend të tij, me këto cilësi, do të kishte mundur të bënte një karrierë të sigurt. Në këtë pikëpamje Engjëllit nuk i kishte munguar asgjë. Djalë i një mjeku të nderuar, me emër të madh në qytetin e Elbasanit dhe Beratit, pushkatuar nga nazistët në dhjetor të vitit 1943 – rreth dy javë para se të vija unë në jetë – ai vetë kishte dalë partizan që në moshën katërmëdhjetëvjeçare. Mirëpo Engjëlli nuk kishte asnjë prirje për karrierë, përkundrazi. Shpesh, duke e çuar subjektivizmin tim, ndoshta në pikën e skajshme, them me vete se ai njeri plot dhunti, ishte lindur në vendin e gabuar, në kohën e gabuar. Sepse, si çdo qenie njerëzore, edhe ai kishte dobësitë e veta, e këto dobësi e çuan në burg.

Unë nuk ia zura kurrë me gojë

Engjëllit vitet e burgut. Më vonë, pas vdekjes së tim ati, gjeta midis materialeve të lëna prej këtij të fundit, edhe një letër, që Engjëlli ia dërgonte nga burgu. As këtë nuk ia zura kurrë me gojë Engjëllit. Është një letër prekëse, pendesa e një njeriu të zënë në faj, ku kërkon ndjesë për shqetësimet që u ka shkaktuar të gjithëve, familjes së tij, të afërmeve, tim ati, të cilin e konsideronte në vend të babait.

Atë e arrestuan kur punonte si mjek në Gjirokastrë, dhe e dënuan plot dymbëdhjetë vjet. Midis akuzave, me sa mbaj mend nga bisedat në familje, ishte edhe ajo për tentativë arratisjeje. Nuk më takon mua të merrem me faktin se sa qëndronin akuzat kundër tij, në çfarë rrethanash iu bënë, kush dhe pse ia bëri etj. E vërteta është se nga dymbëdhjetë vjet që e dënuan, Engjëlli kaloi në burg vetëm dy apo tre vjet. Fill pas lirimit, qe vendosur në qytetin e lindjes.

Miqësinë dhe afërsinë tonë, jo thjesht si kushërinj të parë, ne e ruajtëm edhe më vonë, kur nga Elbasani ai erdhi dhe u vendos në Tiranë. Po ashtu, vazhduam bisedat pa fund për librat, për letërsinë. Që nga viti 1996, unë banoja në një apartament, në zonën e quajtur "Pallatet 1 Maji". Në pallatet aty rrotull banonin edhe Kongolë të tjerë, motra e Engjëllit dhe dy vëllezërit e tij, pranë njëri-tjetrit, pranë meje gjithashtu. Në atë apartament ai

jetoj deri në fund, kur pas disa problemesh shëndetësore u shua.

Dua ta mbyll këtë parantezë për Engjëllin me një konstatim. S'më ka ndodhur të ndesh ndonjë mjek që të mos ketë qenë njohës i stërholluar i letërsisë. Në mos në kuptimin që i japin këtij nocioni studiuesit, së paku që të mos ketë qenë lexues i rregullt, deri në gllabërues librash. Në këtë pikëpamje mendoj se ka ngjashmëri të shumta midis shkrimtarit dhe mjekut. Nuk duhet të jetë e rastit që disa shkrimtarë të përmasave botërore, fjala vjen Anton Çehovi, kanë qenë mjekë.


Atë ditë, kur zumë vend bashkë me Lilin në avionin e linjës Tiranë-Vjenë, unë nuk mund ta merrja me mend se personi në ndenjësën përpara nesh, ishte mjek, aq më pak një mjek mjaft i shquar urolog. Më tërhoqi vëmendjen thjesht sepse në ndenjësën pranë tij ishte ulur një e njohura ime e vjetër, të cilës tani ia mbaj mend vetëm emrin, e quanin Vera. Vera ishte një vajzë simpatike, me sy e flokë të zinj, ish-punonjëse në Shtëpinë Botuese "8 Nëntori". Duke qenë se "Naim Frashëri", ku punoja unë, për një kohë të gjatë ka ndarë të njëjtën godinë me Shtëpinë Botuese "8 Nëntori", ndodhte të shiheshim shpesh korridoreve apo nëpër shkallë etj. Vera kishte studiuar për gjuhë angleze dhe aso kohe punonte në redaksinë e përkthimeve. Nuk

shiheshim dhe s'dinim asgjë për njëri-tjetrin prej një çerek shekulli.

Gjatë fluturimit për në Vjenë, mësova prej saj se ndodhej në Kanada, së bashku me një ish-kolegen time në gazetën "Drita", drejtoresha më e fundit e Shtëpisë Botuese "8 Nëntori", rrjedhimisht edhe shefja e saj më e fundit, Frida Idrizi. Po gjatë fluturimit krijova gjithashtu përshtypjen se burri fjalëpakë, me të cilin më prezantoi, ishte një i njohur i saj. Kjo përshtypje doli e pasaktë. Në Vjenë, për inerci, ne qëndruam bashkë për një kafë, dhe gjatë bisedës kuptova se takimi i Verës me atë person, kishte qenë po aq i rastit sa takimi me mua dhe nuk njiheshin. Tek pinim kafë, Vera e solli fjalën te romani im "Lëkura e qenit". Ajo më tha se ky libër i kishte pëlqyer shumë dhe kishte dëshirë ta përkthente në anglisht. Ajo më pyeti nëse unë isha dakord, që ajo ta përkthente romanin tim në anglisht. Të them të drejtën unë nuk i dija aftësitë e Verës në përkthimin e letërsisë artistike, s'dija që ajo të kishte përkthyer ndonjë libër të kësaj natyre. Megjithatë, më shumë për mirësjellje, i thashë se nuk kisha ndonjë kundërshtim, përkundrazi, por nuk ngurrova t'i bëja një paralajmërim: të mos i hynte një punë të tillë pa gjetur më parë një shtëpi botuese. Me gjithë dëshirën e mirë të Verës, ky projekt nuk u realizua.

Më tej, për përkthimin dhe botimin në anglisht të romanit "Lëkura e qenit", u interesua një shqiptaro-amerikane, zonja Eralda Lameborshi. Aktualisht, zonja Lameborshi jep leksione të "Letërsisë së krahasuar", në "Stephen F. Austin State University", në Teksas. Një ditë mora prej saj një e-mail, përmes të cilit shprehej me vlerësimet më të mira për romanin tim, kishte dëshirë ta përkthente në anglisht dhe kërkoi pëlqimin tim. Sigurisht, rashë dakord, madje, me kërkesën e saj, nënshkruam edhe një kontratë formale. Zonja Lameborshi, të cilën nuk pata mundësi ta takoja ndonjëherë, por komunikuam vazhdimisht përmes internetit, më vuri në dijeni se tashmë kishte përkthyer një dy kapituj të librit, dhe ia kishte çuar një botuesi universitar. Më pas përktheu edhe sprovën time "Një ëndërr europiane mes Al Paçinos dhe Kavabatës", të cilën e kishte gjetur po vetë. Këtë të fundit, si më shkroi, ia kishte paraqitur për botim një reviste. Mirëpo të dyja këto përpjekje të saj dolën pa sukses. Gjithsesi, përfitoj këtu edhe një herë ta falënderoj nga zemra.

Me gjithë kuptimin e fjalës, ka qenë një fat për mua që rasti e solli të njihesha atë ditë me zotin Shpëtim Telegrafi. Para se të zinin vend në avion për të vazhduar fluturimin drejt Nju-Jorkut, ai më dha kartëvizitën e tij. Kur ai më dha kartëvizitën, as që më shkoi nëpër mend se shumë



shpejt do të më duhej ta përdorja atë në çastin e një krize akute, si thonë mjekët.

Nja dy-tri ditë pasi mbërritëm në Nju-Jork, tek bënim me Lilin ecjen tonë të zakonshme në mëngjes herët, te shëtitorja buzë oqeanit, urinova me gjak. Aty për aty nuk pata ndonjë dhimbje, madje fillimisht nuk desha ta besoja, mbase më kishin bërë sytë. Nuk i thashë gjë as Lilin.

Disa minuta më vonë urinova sërish dhe përsëri me gjak, pra shqisat nuk më gabonin. Meqë s'pata ndonjë dhimbje nuk u merakosa dhe aq, sërish nuk i thashë gjë as Lilin, por kur u ktheva në shtëpi s'munda të mos shqetësohesha.

Ishte ende shumë herët. Pa i bërë dot ballë tundimit, dhe gjithnjë pa i thënë Lilin asgjë, iu drejtova kompjuterit: desha të mësoja domethënien e urinimit me gjak. Hasa lloj-lloj interpretimesh, deri te kanceri i veshkave. Të them të drejtën e humba toruan dhe mendja më vajti vetvetiu te doktor Shpëtimi, me të cilin isha njohur vetëm para dy-tri ditësh. Nuk e mbaj mend mirë nëse e mora në telefon, apo i dërgova një e-mail, ku ia shpjegoja gjendjen time, që ndërkaq po përkeqësohej, kisha filluar të ndieja edhe dhimbje, që dora dorës po bëheshin të forta. Fakti është se doktor Shpëtimi m'u përgjigj menjëherë. Ai më tha të shkoja tek ai në klinikën ku punonte, rreth orës dymbëdhjetë të asaj dite.

Klinika në fjalë ndodhej në Manhatan. Rajoni i policisë ku shërbente Doriani ndodhej gjithashtu në Manhatan, kështu

mbushur me hapje.

Dhimbjet më pushuan sapo u kthyem në shtëpi dhe piva hapjet, sipas udhëzimit të doktorit. Afër mbrëmjes, kur unë praktikisht nuk ndieja më as dhimbje, as nuk urinoja më me gjak, ai më mori në telefon. Më pyeti si isha, dhe unë iu përgjigja se isha fare mirë, hapjet e tij më kishin lehtësuar menjëherë, më kishin shpëtuar gjithashtu nga urinimi me gjak. Megjithatë, doktorin nuk ngurroi të më jepte një porosi: nëse ndieja prapë dhimbje të mbushja vaskën e banjës me ujë të ngrohtë dhe të zhytesha në ujë. Po ta shihja keq, të nesërmen të shkoja prapë tek ai, në klinikë.

Nuk doli nevoja. Më pas unë nuk pata asnjëherë një problem shëndetësor të kësaj natyre, ndonëse hapjet që më kishin tepruar i ruajta për një kohë të gjatë. Shënoj se ky ka qenë rasti i parë që m'u desh të shkoja te klinika në Manhatan. Them kështu sepse rreth një vit më vonë unë shkova përsëri atje. Pas një kontrolli dhe analizave në Shqipëri për prostatën, lindën ca dyshime dhe me porosinë e mikut tim të vjetër doktor Nestor Thereckës, unë vajta përsëri te doktor Shpëtimi. Doktorin u tregua sërish i gatshëm të më ndihmonte dhe më shoqëroi te një koleg i tij i klinikës, një mjek amerikan, specialist i prostatës. Ky më vizitoi, u hodhi një vështrim analizave që kisha bërë në Shqipëri dhe më qetësoi përfundimisht: gjendja e prostatës sime ishte normale, në përputhje me moshën. Mbaj mend se në këtë vajtje të dytë te klinika në Manhatan, më shoqëroi Elda. Përtej problemeve shëndetësore, kujtimi më i bukur i njohjes sime me doktor Shpëtimin është një tjetër vizitë, kësaj radhe jo te klinika në Manhatan. Një vizitë në shtëpinë e tij, ku ai na ftoi mua dhe Lilin të shkonim për drekë. Doktorin banonte në një nga lagjet më shik të Nju-Jorkut, lagje njerëzish të kamur, në zonën e

quajtur "Upstate". Takimin na e la te klinika në Manhatan dhe prej andej, me makinën e tij, vajtëm në "Upstate". Një hapësirë e qetë, plot gjelbërim, e pyllëzuar.

Makina ndaloi para një vile dykatëshe, me një garazh të madh përbrë, tipike amerikane. Atje na priti bashkëshortja e doktorit, me të cilën Lili u miqësua shumë shpejt. Madje, pasi drekuam, gruaja nuk ngurroi ta ftonte Lilin për të parë të gjitha ambientet e vilës së madhe. Kuptohet, Lili mbeti e mrekulluar.

Pasdite, atje mbërritëm për të na marrë ne, Dori me bashkëshorten e tij, Irinën. Të zotët e shtëpisë këmbëngulën që ata të uleshin për të ngrënë dhe, ç'është e vërteta, ata nuk i bënë fort naze tryezës që u shtruan. Para se të largoheshim, në shenjë falënderimi, Dori i dha doktorit diçka që ky e vlerësoi jashtëzakonisht. Mendoj se ia vlen të ndalem në atë "diçka", që doktorin e vlerësoi aq shumë.

Im bir, si të gjithë oficerët e policisë së Nju-Jorkut, zotëronte një numër të caktuar kartash, me përdorim vjetor, në formatin e një kartëvizite. Këto ai mund t'ua jepte pjesëtarëve të familjes, apo disa të njohurve, që të mund t'i përdornin. Si dhe pse? Për t'ia paraqitur oficerëve të tjerë të policisë, në rast se ndaloheshin prej tyre për kundërvajtje, fjala vjen në shkelje të rregullave të qarkullimit, parkime të gabuara etj., e kështu t'u shmangeshin jobave.

Sado e çuditshme të duket, kjo është e vërtetë. Kur ia kam treguar këtë fakt një mikut tim gjerman, ai nuk deshi ta besonte. Mirëpo, jo çdo gjë e Amerikës është e kuptueshme në Europë. As kjo shenjë solidariteti në familjen e madhe të policisë së Nju-Jorkut, që më shumë tingëllon si privilegj "brenda llojit". Ja përse doktor Shpëtimi e vlerësoi mjaft kartën që i dha Doriani./Exlibris



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Fazliu: Katër pikë nuk janë shumë, duhet të vazhdojmë me fitore

Sulmuesi Astrit Fazliu ka thënë për "Epokën e re" se dallimi prej katër pikëve me skuadrën e dytë në tabelë nuk duhet ta vetëkënaqë klubin gjilanas pasi ende ka shumë ndeshje për t'u zhvilluar. "Është shumë mirë për skuadrën e Dritës dallimi prej katër pikëve me skuadrën e dytë, por kjo nuk do të thotë se jemi favoritë absolutë në garën për titull të kampionit në elitë, sepse ka edhe shumë ndeshje për t'u zhvilluar dhe në futboll mund të ndodhë gjithçka", ka thënë Fazliu



Dukagjinin edhe pse është në pozitën e fundit në tabelë. Ky klub ka treguar se mund të jetë i vështirë për t'u mposhtur, por ne kemi ambicie të mëdha dhe nuk guxojmë të gabojmë në këtë ndeshje", ka deklaruar ai. Drita nga 26 ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar 17 fitore, 4 barazime dhe 5 humbje, duke u renditur në pozitën e parë me 55 pikë.

IPKO SUPERLIGA - JAVA E 27-t

Të dielën takohen:

Drita - Dukagjini
Drenica - Trepça '89
Flamurtari - Ferizaj

Të hënën takohen:

Gjilani - Llapi
Ballkani - Vushtrria
Prishtina - Feronikeli

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Skuadra e Dritës me tri pikët e marra nga Vushtrria dhe me barazimin e Prishtinës në ndeshjen kundër Llapit e ka rritur epërsinë në katër pikë. Gjithashtu, në favor të Dritës ishte edhe barazimi i Ballkanit në përballje me Ferizajn.

Pavarësisht prej dallimit në katër pikë me skuadrën e parë përcjellëse, sulmuesi i Dritës, Astrit Fazliu, ka qenë mjaft i matur në deklaratën e tij lidhur me titullin e kampionit në IPKO Superligë për edicionin 2019/2020. "Është shumë mirë për skuadrën e Dritës dallimi prej katër pikëve me skuadrën e dytë, por kjo nuk do të thotë se jemi favoritë absolutë në

garën për titull të kampionit në elitë, sepse ka edhe shumë ndeshje për t'u zhvilluar dhe në futboll mund të ndodhë gjithçka", ka thënë Fazliu për "Epokën e re". "E vërteta është se jemi në pozicion më të mirë se kundërshtarët, po ashtu edhe forma e skuadrës është e lartë. Ne do të përpiqemi ta japim maksimumin në secilën ndeshje dhe do të shkojmë

ndeshje pas ndeshje deri në fund të kampionatit dhe besoj se do t'ia arrijmë qëllimit", ka shtuar Fazliu.

Ndeshjen e radhës Drita e zhvillon të dielën kundër Dukagjinit në Gjilan. Sulmuesi me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, Astrit Fazliu, ka konfirmuar se nga kjo ndeshje synohen tri pikët e reja. "Ne e respektojmë

Sot zhvillohen gjysmëfinalen e Kupës në hendboll

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Një vit më parë Kastrioti i Ferizajt i pati fund dominimit të Besa Famgas në garat për Kupë të Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Kastrioti e ka fituar Kupën, duke i dhënë fund serisë së Besës prej pesë triumfeve rresht. Por, Besa Famgas ka vazhduar dominimin në Superligë, kurse të martën ka fituar titullin e shtatë rresht. Besa synon ta kthejë edhe Kupën e Kosovës, por për të bërë këtë fillimisht duhet ta kalojë Kastriotin në gjysmëfinale të Kupës së Republikës së Kosovës. Kastrioti e Besa Famgas takohen sot (e shtunë) nga ora 17:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Besa Famgas ka



eliminuar Kastriotin në gjysmëfinale të plejofit dhe shorti ka përcaktuar që këto dy skuadra të takohen edhe në gjysmëfinale të Kupës.

Në gjysmëfinalen e dytë takohen Trepça e Prishtina. Kjo ndeshje është të shtunën nga ora 19:00 po në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në kryeqytet. Këto dy

skuadra ishin takuar edhe në gjysmëfinale të plejofit. Fillimisht Trepça ka fituar në Prishtinë me tetë gola dallim, por më pas Prishtina ka fituar në Mitrovicë me 11 gola dallim dhe ka kaluar në finale. Ndeshjet finale në të dyja konkurrencat luhen të dielën në të njëjtin vend.

Ndeshje interesante edhe në konkurrencën e femrave

Sot (e shtunë) luhen ndeshjet gjysmëfinale të Kupës së Republikës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Fillimisht prej orës

13:00 takohen Istogu dhe Kastrioti i Ferizajt. Istogu është fitues në fuqi i Kupës, ndërsa synon kalimin në finale. Istogaset e humbën finalen e plejofit dhe tani kanë pretendime për ta fituar kupën. Por, synimet e saj i ka edhe skuadra e Kastriotit. Ndeshja Istogu - Kastrioti luhet në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, ku luhet i gjithë turneu përfundimtar i Kupës. Interesante pritet të jetë edhe ndeshja në mes të Vushtrrisë dhe Prishtinës që zhvillohet nesër nga ora 15:00. Këto dy skuadra ishin ndalur në gjysmëfinale të plejofit, kurse tani synojnë kalimin në finale, më pas edhe trofeun.

Ademi merr leje të luajë për Zvicrën

CYRIH, 26 QERSHOR - Sulmuesi Kemail Ademi ka marrë lejen që të luajë për Kombëtaren e Zvicrës. Ky është një lajm i keq për Kosovën, pasi sulmuesi në fjalë ishte shumë i dëshiruar nga përzgjedhësi i "dardanëve", Bernard Challandes. "Në mënyrë që ta fitojë të drejtën e lojës, Federata e Futbollit e Zvicrës dhe Ademi është dashur të prezantojnë shumë doku-

mente dhe arsye të FIFA. Pas ekzaminimit të aplikimit, është dhënë leja. Kemal Ademi në dhjetor të vitit 2002, si gjashtëvjeçar, erdhi së bashku me familjen në kantonin Appenzell-Ausserrhoden. Ai ka jetuar në Zvicër për gati 14 vjet dhe është shtetas zviceran prej vitit 2011. 24-vjeçari ka kontratë me Baselin", ka njoftuar Federata zvicerane.



Ruiz: Dua të përballem me Whyten që t'ia mbyll gojën

Londër, 26 qershor - Ish-kampioni i botës në peshën e rëndë, boksieri meksikan Andy Ruiz Jr, ka deklaruar se dëshiron të përballlet me çdo kusht me britanikun Dillian Whyte. Meksikani kërkon t'ia mbyllë një herë e

mirë gojën rivalit, pas deklaratave që Whyte ka bërë kundër Ruizit. Dillian Whyte ka deklaruar më herët se i ka ofruar pesë milionë dollarë Andy Ruiz për t'u përballur së bashku, por meksikani ka

refuzuar. "Unë kam disa prioritete në karrierën time dhe shpresoj t'i realizoj ato. Dua ta befasoj sërish botën, por dua të vë edhe pak drejtësi", ka thënë Ruiz. "Të gjithë e dinë që dua të dueloj ndaj Furyt apo sërish ndaj

Joshuas. Por, dua edhe të përballlem me Dillian Whyte dhe t'ia mbyll gojën, pasi thotë shumë gjëra të pasakta për mua. Shpresoj ta arrijmë një marrëveshje për t'i treguar atij se kush jam unë", ka deklaruar Ruiz.



Boksieret Sadiku dhe Brahim, në përgatitje bazike

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Boksieret e Kosovës, Donjeta Sadiku dhe Alnera Brahim, janë duke i kryer përgatitjet bazike për sfidat që i presin në të ardhmen, njofton Federata e Boksit e Kosovës. Këto përgatitje do të mbështeten 50 për qind nga Komiteti Olimpik i Kosovës me vendim të Bordit Ekzekutiv të KOK-ut.

Nënkampionia e botës, kampionia evropiane dhe kandidatja kryesore për pjesëmarrje në Olimpiadën e Tokyos, Donjeta Sadiku, do të përgatitet në Struzhë së bashku me partneren Alnera Brahim dhe trajneren Marjola Sallauka.

Përgatitjet bazike do të zgjasin 14 ditë dhe do të zhvillohen në lartësi mbidetare prej 1200 metrash, ku do të përfshihen ushtrimet e forcës, kondicioni, qëndrueshmëria e



të tjera. Ushtrimet do të zhvillohen tri herë në ditë, gjithnjë duke i respektuar këshillat e dala nga OBSH-ja, MSH-ja dhe IKShP-ja. "Këto përgatitje janë të mirëseardhura, sidomos për Donjeta Sadikun, e cila duhet ta ruajë formën dhe t'i

vazhdojë përgatitjet, që të jetë e gatshme për vazhdimin e garave kualifikuese për Lojërat Olimpikë, të cilat u ndërprejnë në muajin mars në Angli, ku Donjeta startoi me fitore kundër boksieres nga Gjermania", ka njoftuar Federata e Boksit.

Ja si e fitoi Liverpooli titullin pas 30 vjetësh

LIVERPOOL, 26 QERSHOR - Pritën 30 vjet për titullin në Premierë Ligë, por tani gjithçka është harruar. Liverpooli dhe tifozët e tij mund ta vijnë gjatë festën deri kur ta marrin zyrtarisht në dorë trofeun e kampioneve të Anglisë, por deri atëherë specialistët, teknikët, ata që merren me statistika dhe mediat mund ta bëjnë bilancin e një sezoni spektakolar për Jurgen Kloppin dhe të besuarit e tij.

Për këtë janë të gjithë të bindur: ky ishte një sukses më shumë se i merituar. Do të ishte e çuditshme, por edhe nëse dikush nuk e pëlqen mënyrën se si luajnë "Reds", atëherë duhet t'i shohë shifrat dhe të heshtë. Kur mbeten edhe shtatë javë deri në fund të Premierë Ligës, Liverpooli ka grumbulluar 86 pikë, me 28 fitore, 2 barazime dhe vetëm një humbje. Po ashtu, skuadra e Kloppit ka sulmin e dytë më të mirë, pas Manchester Cityt me 70 gola të shënuar dhe mbrojtjen më të mirë me vetëm 21 gola të pësuar. Shifra që kanë vendosur rekorde në historinë e klubit dhe që në deri në fund të sezonit mund të vendosin të tjera limite në



historinë e futbollit anglez. Kështu, Liverpooli ka në dorë t'i thyejë rekordet e Manchester Cityt, atë të fitoreve dhe pikëve të grumbulluara në një

kampionat të vetëm. Arsye të rëndësishme, që megjithëse tani zyrtarisht kampion, do t'i motivojnë "të kuqtë" ta ruajnë ritmin deri në fund.

SHKURT

Torino ia vazhdon kontratën Ujkanit

Skuadra e Torinos ka njoftuar se portierit të Kosovës, Samir Ujkani dhe disa futbollistëve të tjerë u është vazhduar kontrata deri më 31 gusht. Pandemia COVID-19 dhe mosarritja e përfundimit të sezonit me kohë kanë bërë që shumë lojtarë të mbesin pa kontrata pas 30 qershorit. Torino ka ndërmarrë veprimin, duke ua ofruar zgjatjen e kontratave disa lojtarëve deri në përfundim të këtij sezoni.

Flamurtari nënshkruan me 6 futbollistë

Flamurtari nga Prishtina, krahas garës për mbijetesë në IPKO Superligë, është duke menduar edhe për të ardhmen e futbollistëve nga shkolla e futbollit. Klubi "kuqezi" ka nënshkruar kontratë me gjashtë futbollistë nga academia e klubit. Bëhet fjalë për Fisnik Ahmetin, Jeton Selimin, Eron Rafunën, Yll Cahanin, Gentrit Gashin dhe Ardit Hasani. "Fisnik Ahmeti, Jeton Selimi, Eron Rafuna, Yll Cahani, Gentrit Gashi, Ardit Hasani nënshkruajnë kontratat e para me klubin tonë. Flamurtari mendon për të ardhmen dhe futbollistët nga shkolla e vet. Ju prift e mbara djelmosha kuq e zi", thuhet në njoftimin e Flamurtarit.

Benitezi uron Liverpoolin për titullin e kampionit

Ish-trajneri i Liverpoolit, Rafa Benitez, përgëzoi të kuqtë pasi u kurorëzuan kampionë të Anglisë pas 30 vjetësh pritjeje. Tekniku spanjoll përgëzoi ekipin e Jurgen Kloppit me anë të një mesazhi në "Twitter". "Urime Liverpoolit që pas 30 vjetësh e realizoi ëndrrën! Jemi të gjithë të kënaqur me të kuqtë! Kurrë nuk do të ecni vetëm!", ka shkruar Benitez, i cili është një prej trajnerëve më të suksesshëm në historinë e Liverpoolit.

Guendouzi kërkon të largohet nga Arsenalit

Matteo Guendouzi duket gjithnjë e më larg Arsenalit. Mesfushori franko-maroken ka pasur probleme këtë sezon si nga ana sportive ashtu edhe nga ajo disiplinore, ku i fundit ishte lënia jashtë sfidës ndaj Suothamptonit pas sjelljes së shëmtuar me Maupay të Brightonit. Në mbledhjen që ka pasur me bordin drejtues 21-vjeçari ua ka komunikuar vendimin për t'u larguar këtë verë, por nuk do të jetë e lehtë, pasi klubi e vlerëson 40 milionë euro kartonin e tij, shumë që vështirë ta paguajnë klubet e interesuara.

Klopp: Jam i shokuar, kam pritur tri vjet për këtë çast

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, i kontaktuar nga "Sky Sports" pas shpalljes matematikisht kampion i Premierë Ligës, u shfaq para kamerës tepër i emocionuar. "Është e jashtëzakonshme të jesh kampion me këtë ekip. E kam pasur shumë të thjeshtë t'i motivoja lojtarët për shkak të historisë së madhe që ka klubi. Është një arritje e jashtëzakonshme për lojtarët e mi. Është gjithçka që ata kanë bërë për tre vjetët e fundit", ka thënë Klopp.

Trajneri gjerman u shfaq në një lidhje të drejtpërdrejtë me legjendën e Liverpoolit, Kenny Dalglish, të cilin e falënderoi për të gjithë mbështetjen që i dha. Përveç kësaj, Kloppi u bëri thirrje tifozëve që ta festojnë titullin duke respektuar masat dhe të mos dalin në rrugë si të çmendur. "Shpresoj të qëndroni në shtëpi. Kjo është në zemrat tona dhe në kokat tona. Dilni më së shumti në oborrin e shtëpisë", ka deklaruar Kloppi.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimin e Bordit të datës 25.06.2020 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 26.06.2020 të shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Asistent/e - Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët e asistentit të cilat i përcaktonë Kryeshefi Ekzekutiv si dhe Sekretarja e Kompanisë.
- Pranon palët dhe i prezenton të K.E për pranim, mban evidencën zyrtare të thirrjeve telefonike dhe takimeve.
- Pranon thirrjet dhe shkresat, kryen punët kompjuterike nga fushëveprimtaria e punëve dhe detyrave të punës, si dhe punë tjera teknike që i cakton Kryeshefi Ekzekutiv si dhe Sekretarja e Kompanisë, siq janë shumëzimi dhe fotokopjimi i materialeve, mbajtja e protokollit dhe arkivimi i dokumenteve dhe të postës për dorëzim intern dhe ekstern, i të njejtave.
- Nëse është nevoja edhe qëndrimin më të gjatë se orari i rregullt i punës në raste të veçanta kur ka mysafir afarist apo mbledhje të rëndësishme në Kompani. Si dhe punë tjera të kësaj natyre.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Të ketë shkollën e mesme ;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj);
- Shkathtësi në komunikim, me stafin brenda Kompanisë;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Exel); ose administrative.

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 26.06.2020 deri më datën 11.07.2020. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Kompania Regionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURIT

Kompania Regionale e Mbeturinave "Uniteti"Sh.A zgotë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

1 Punëtor Fizik - Njësia në Mitrovicë - K.R.M. "Uniteti" Sh.A- I Konkursit të shpallur me datë 05.06.2020

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati I konkurimit vazhdohet prej datës 26.06.2020. deri me datë 03.07.2020 deri në orën 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës,nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M "Uniteti" Sh.A.- Mitrovicë.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

CV

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Valentin Juriku shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Leke Dugagjini " Prizren.
- ▶ Qendrim Nervoja shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.
- ▶ Haki Ramadani shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Lëshoj banes me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Erti 2” L.L.C Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Qirez komuna e Skenderajt.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 24.07.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant “Freskia” rruga “Skenderbeu” pn., në Skenderaj do të organizohet debat publik nga kompania “Erti 2” L.L.C Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Qirez komuna e Skenderajt.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova/ Republika of Kosovo
Komuna Dragash/ Opštine Dragaš/ Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM DRAGASH



Në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësit të cilat i ka Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, merr këtë:

VENDIM

Për anulimin e pjesërishtëm të konkursit për mësimdhënës nr.13/250 të dates 10.06.2020

1. Anullohet pjesërishtë, procedura e rekrutimit për konkursit të shpallur publik nr.13/250 të dates 10.06.2020, i publikuar në Gazetën Epoka e Re me datë 11.06.2020, vendi i punës mësimdhënës për mësim klasor mësimi në gjuhë shqipe.
2. Anulimi i konkursit nga pika 1 e këtij vendimi behët meqë jemi në pjesën e fundit të përfundimit të vitit shkollor 2019/20 dhe për faktin së DKA ka filluar procesin e analizimit dhe konsolidimit të normave mësimor në institucionet edukativo arsimore për vitin në vijim, si dhe procesin e riorganizimit të disa paraleleve të ndara në IEAA-ve, me qëllim që t i mbrojmë tepricat e mundshme të personelit arsimor në shkolla, kjo procedur e rekrutimit **Anullohet** sipas pikes 1 të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

Me respect

Drejtori i Arsimit në Dragash

MSc.Vloran Cenaj

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Korabi” Sh.p.k. Landovicë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Dushanovë komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.07.2020 në ora 11:00 në lokalet e bazës se betonit në Dushanovë, magjistrerja Prizren-Gjakovë do të organizohet debat publik nga kompania “Korabi” Sh.p.k. Landovicë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Dushanovë komuna e Prizrenit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Javori – F” Sh.p.k Gorazhdefc, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperacionin e inerteve në Gorazhdefc komuna e Pejës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.07.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant “Univers-Pejë” adresa Fusha e Pejës, Pejë do të organizohet debat publik nga kompania “Javori – F” Sh.p.k Gorazhdefc, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperacionin e inerteve në Gorazhdefc komuna e Pejës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULË

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues